# 2008 2008 2008

## ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ RAPORTI I PUNËS ANNUAL REPORT

Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonise
Macedonian Red Cross



**Librin „Kujtimet për Solferinon“, Anri Dinan e ka shkruar me nxitje nga frikat e një beteje, e cila më tej solli deri në krijimin e lëvizjes humanitare e cila sot është prezente në mbarë botën. Shpirti humanitar i cili mbizotëron në Kryqin e Kuq / Gjysëmhënën e kuqe, nga vet fillimi është i lidhur me situata ku njeriut i nevojitet ndihmë nga ata që janë në gjendje që ta japin atë**

2008 | 56

# Përmbajtja

Parime / Vizion / Mision 58
Porosi nga Kryetari dhe Sekretari gjeneral i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë 59
Mbindërtim intenziv të kapaciteteve 60
Hetim të qëndrimeve dhe mendimeve të sektorit korporativ për Kryqin e Kuq të RM 62
Organizim dhe zhvillim 64
Diseminim 66
Veprimtaria shëndetësore - preventive 70
Ndihma e parë 72
Dhurimi i gjakut 74
Veprimatria socialo - humanitare 76
Përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave 80
Të rinjët e Kryqit të Kuq 84
Informim dhe marëdhënie me publikun 88
Materiale të shpallura 90
Bashkëpunim ndërkombëtar 92
Shërbimi për kërkim 94
Projekte të realizuara 96
Punë finansiare materiale 98
Anëtarë të Këshillit ekzekutiv të Kryqit të Kuq të RM-së 104
Raporti i revizorit të pavarur 105
Hetim i mendimit publik për besim në shoqërinë qytetare 106
Falenderim deri te vullnetarët, anëtarët e organizatës, partnerët dhe donatorët 108
Marrëveshje dhe Memorandume për bashkëpunim 109

# PARIME THEMELORE TË LËVIZJES

**HUMANIZËM**Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe u bë si rezultat i dëshirës që t'iu ndihmohet të të plagosurve në fushën e betejës edhe atë pa kurfarë paanshmërie, si dhe ta ndalojë dhe ta lehtësojë vuajtjen e njerëzimit çdoherë kur ajo është e mundëshme. Qëllimi i lëvizjes është që ta mbrojë jetën dhe shëndetin dhe ta respektojë njeriun. Promovon kuptim të përbashkët, shoqëri, bashkëpunim dhe paqe të përherëshme mes të gjithë njerëzve. **PAANSHMËRI** Nuk bën diskriminim në bazë të përkatësisë nacionale, racore, fetare dhe përkatësi klasore apo bindshmëri politike. Vazhdon që t'i lehtësojë vuajtjet e individëve duke u bazuar me përjashtim të nevojave të tyre por, duke i dhënë përparësi rasteve më urgjente. **NEUTRALITET** Për ta kënaqur besimin e të gjithëve, lëvizja nuk guxon që të marë natyrë politike, racore, fetare apo ideologjike. **PAVARSI** Lëvizja është e pavarur. Shoqatat nacionale edhe pse veprojnë si plotësim i shërbimeve humanitare të qeverive dhe janë mjet i rreguëllimit të legjislativës nacionale, patjetër duhet ta rujajnë autonominë që të mund të veprojnë në çdo kohë, në pajtueshmëri me parimet e Lëvizjes. **SHËRBIMI VULLNETAR** Është lëvizje për dhënien e ndihmës vullnetare i cili është inspiruar nga motivet materiale. **BASHKIM** Në një shtet mund të ketë vetëm një shoqatë nacionale të Kryqit të Kuq apo Gjysëmhënës së Kuqe. Patjeter duhet të jetë e hapur për të gjithë dhe ta kryejë punën e sajë humanitare në të gjithë teritorin në vend. **UNIVERZALIZËM** Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, ku të gjitha shoqatat që e përbëjnë kanë status të njejtë, përgjegjësi dhe detyrime që të ndihmojnë.

# VIZIONI

## I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Patjetër duhet të jemi të përgatitur që t'i shfrytëzojmë mundësitë në fillim, sepse që të jeshë në fund do të thotë të jeshë jashtë lojës. Ne jemi pjesë e familjes humane dhe do të jemi liderë në realizimin e misionit human.

# MISIONI

## I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

"Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë është humanitar, organizatë vullnetare e cila vepron në pajtueshmëri me parimet themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare, duke punuar në planin e sigurimit të ndihmës dhe shërbimeve për popullatën e mjeruar dhe promovimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe vlerave humane ".

*Porositë të cilat dalin nga ky raport flasin për arritjet, sfidat dhe detyrimet tona të cilat i marim për periudhën që qëndron para nesh. Tregojmë se humaniteti dhe akcioni humanitar japin fryt në shumë segmente të shoqërisë sonë si rezultat i punëve të vazhdueshme të mijërave vullnetarë dhe të punësuar të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Për atë qëndrojmë fortë të bëjmë dallim pozitiv në jetën dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor të popullatës së mjeruar në bashkësitë lokale të shtetit tonë.*

*Me qëllim që të ruhet integriteti i organizatës sonë dhe besimi i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë me të cilët, dhe për të cilët punojmë, në procesin e implementimit të aktiviteteve programore dhe projektuese vazhdimisht kthehemi në parimet tona themelore të Lëvizjes që të vërtetohemi se aktivitetet të cilat i marim janë në shpirtin e këtyre parimeve.*

*Aktivitetet tona në vitin 2008 ishin të drejtuara në sfidat humanitare dhe në gjendjet krizore por edhe në përgatitjen e planifikimit, përkrahjes së bashkësive lokale në mbindërtimin e kapaciteteve, sigurimin e mundësive për popullatën e mjeruar që ta përmirësojë jetën e tyre si dhe punët për rekonstruimin e brendshëm të organizatës për arritjen e efikasitetit më të madh në punë.*

*Aspekt kyç në këtë proces ishte ndërimi i marëdhënieve partnerore me institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare, sektorin korporativ dhe Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe. Lidhjet e ndërtuara partnerore mundësuan implementimin e spektrit të gjërë të programeve dhe projekteve nëpërmjet të cilëve me sukses u ballafaquam me shumë sfida të planit shëndetësor preventiv, problemeve sociale, përgatitshmëri dhe mënjanimin e pasojave të nxitura nga katastrofa, aktivitete të të rinjëve, diseminim, mbindërtim të kapaciteteve personale dhe kapaciteteve të bashkësive lokale.*

*Në vitin e kaluar bëmë hapa inovative në planin e ndërtimit efikas të sistemit informativ menaxhment, menaxhim me resurset kadrovike dhe mobilizimin e fondeve për implementimin e aktiviteteve programuese dhe projektuese në drejtim të krijimit të bazës së fortë për punë afatgjate. Lëmitë programuese të shoqatës nacionale ishin mjete të vlerësimit dhe evaluimit të gjërë çka rezultonte me përgatitje dhe sjellje të strategjive dhe obligime afatgjate operative për çdo veprim të organizatës. Viti i kaluar ishte vit zgjedhor që e shënuan trajnime dhe takime të shumta instruktive për potencialet kadrovike të organizatave komunale të Kryqit të Kuq. Duke pasur parasysh se suksesi i organizatës matet në nivel lokal ku sigurohen shërbimet dhe përkrahjet për shfrytëzuesit, obligim primar i yni në vitin që vijon është që të vazhdojmë me mbindërtim të vazhdueshëm të kapaciteteve kadrovike dhe materiale të organizatave tona komunale. Transformimi dhe riorganizimi i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në katër vitet e kaluara zhvillohen pozitivisht çka na jep të drejtë të besojmë se lëvizim në kahje të drejtë në realizimin e obligimit tonë që të jemi shoqatë nacionale e cila funksionon mirë me aftësi të përballohet me sfidat dhe nevojat e kategorive të ndryshme të popullatës të cilëve iu shërben Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë.*

*Suksesi i punës sonë matet me numrin e shërbyer të shërbyesve të shërbimeve tona dhe aktiviteteve promotive ku në vitin e kaluar numri i tyre ishte i shumtë. Raporti vjetor i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për vitin 2008 përmban retrospektivë të shkurtë të implementimit të aktiviteteve programore dhe projektuese, rezultatet dhe arritjet tona dhe përcaktimet reformuese janë të nënvizuara për periudhën që vijon.*

**Sait Saiti**
**Sekretar gjeneral**

**Dr. Milcho Trajkovski**
**Kryetar**





Vitin e kaluar posaçërisht e shënon aplikimi i suksesshëm projektues i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë i dorëzuar dhe lejuar nga Fondi për mbindërtim intenziv të kapaciteteve të Federatës Ndërkombëtare. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë ishte shoqata nacionale e vetme e zgjedhur nga Europa e cila me përkrahjen e Fondit do të implementojë aktivitete në periudhë prej tre vitesh të drejtuar zhvillimi i mëtejmë të kapaciteteve materialo - teknike dhe kadrovike në nivel komunal dhe shtetëror me qëllim që Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë të menaxhohet me sfidat me të cilat ballafaqohet popullata e mjeruar në bashkësitë lokale.

Aktivitetet e parapara në projekt filluan që të implementohen kah mesi i vitit 2008 në tre lëmi programore edhe atë: ndërtim i sistemit efikas informativ menaxhment, menaxhment të vullnetarëve dhe të punësuarve dhe mobilizim të fondeve. Përskaj mjeteve të siguruara nga Fondi për mbindërtim intenziv të kapaciteteve të siguruara nga Federata Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, të gjitha aktivitetet të cilat u realizuan në periudhën e lartëpërmendur, por edhe në dy vitet e ardhëshme janë përkrahur edhe nga Fondi për Zhvillim të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, me çka paraqitet si partner me të drejtë të plotë të Federatës Ndërkombëtare në realizimin e projektit.

## SISTEM EFIKAS INFORMATIV MENAXHMENT

Inkorporimi i arritjeve dhe mundësive të reja të teknologjive informativo komunikuese në punën e një organizate paraqet element kyç për mbindërtimin esencial të kapaciteteve, rrjedhje më të shpejtë të informacioneve, transparecë e rritur dhe përpunimit automatik të të dhënave të gjitha pjesëve integrale të shoqatës nacionale qëllim primar i këtij aktiviteti është që të zbatohet rrejt infrastrukturor kompjuterik dhe lidhje elektronike të Qendrës së Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë me organizatat komunale të Kryqit të Kuq. Qëllimet funksionale të cilat do të arrihen janë ndërtimi i strukturës elektronike rrejtore të organizatës, kontrolli i vazhdueshëm i informacioneve për resurse, ngjarje dhe aktivitete të zbatuara, online foto galeri, analizë e karakteristikave demografike dhe karakteristikave tjera organizative, strukturë dhe organizim i resurseve kadrovike dhe materialo teknike, analizë dhe raport i njësive organizative, programe, projekte dhe aktivitete.



Në katërmujorshin e fundit të vitit 2008 filluan përgatitjet dhe instalimi i sistemit informativ menaxhment, kurse deri në fund të vitit 2008 u zbatua edhe lidhja rrjetore e Qendrës, Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të Kryqit të Kuq në Shkup, kurse në shkurt të vitit të ardhshëm me rrejt do të lidhen edhe organizatat tjera komunale në të gjithë Maqedoninë dhe do të përgatiten aplikimet softuerike për përmbajtje të ndryshme programore të shoqatës nacionale.

## MENAXHMENT I VULLNETARËVE DHE TË PUNËSUARËVE

Qysh nga vet formimi i Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe vullnetarët janë fuqia lëvizëse për implementimin e aktiviteteve të dedikuara për ndihmë dhe përkujdesje të popullatës së mjeruar. Mobilizimi i vullnetarëve nga bashkësitë lokale për kënaqjen e nevojave lokale është një ndër detyrat dhe qëllimet prioritare të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Për atë shkak një ndër detyrimet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë është zhvillimi i formave dhe modeleve për tërheqjen dhe mbajtjen e vullnetarëve për zbatimin e aktiviteteve të përditshme duke i promovuar parimet themelore dhe vlerat humane të Lëvizjes. Menaxhimi i vullnetarëve dhe personave të punësuar paraqet proces të planifikimit dhe vendosjes, organizimit, udhëheqjes dhe kontrollimit të resurseve njerëzore dhe menaxhmentit finansiar për shkak të realizimit të qëllimeve të organizatës në mënyrë efektive dhe efikase.

Aktivitetet të cilat implementohen në fazën e parë të projektit për “Mbindërtim intenziv të kapaciteteve” janë adaptimi i Udhëzimi për implementimin e Rregullores për vullnetarizim të Federatës Ndërkombëtare, Publikimit për menaxhimin e ciklit për vullnetarizim. Ata shërbyen për përgatitjen e Strategjisë për vullnetarizim të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2008 – 2012 që ishte prezantuar publikisht më 4 dhjetor në kornizë të shënimit të Ditës Botërore të vullnetarizimit.

## MOBILIZIMI I FONDEVE

Në kuadër të aktiviteteve të cilat janë ndërmarrur dhe planifikuar në vitin e parë nga implementimi i projektit për mbindërtim intenziv të kapaciteteve të shoqatës nacionale, poasçërisht për shënimin e hetimit të zbatuar për qëndrimet dhe mendimet e sektorit korporativ për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë. Rezultatet nga ky hetim shërbyen për përgatitjen e Strategjisë për mobilizimin e Fondeve të KKRM për periudhën 2008 – 20012, e cila ishte e prezentuar publikisht para sektorit korporativ në Qershor të vitit 2008. Në vazhdim është përkthimi dhe adaptimi i doracakut për mobilizimin e fondeve i cili do të përdoret për trajnimin e resurseve njerëzore në organizatat komunale të Kryqit të Kuq.

Të gjitha këto aktivitete duhet të kontribuojnë për hasjen e aftësive dhe diturive të reja për mobilizimin e fondeve në organizatat komunale të Kryqit të Kuq të cilat do të përdoren për aktivitete programore dhe projektuese. Implementimi i projektit do të kontribuojë për zbatimin e sistemit të brendshëm efikas për zbatimin e aktiviteteve të marketingut, ndërtim të kornizës normative për mobilizimin e fondeve dhe gjithashtu mundësi të rritura të shoqatës nacionale të të gjitha niveleve për sigurim të suksesshëm të mjeteve materialo finansiare e tjera për nevojat e organizatës.

**Në drejtim të tërhjeqjes së partnerëve dhe përkrahësve të rinj të aktiviteteve të Kryqit të Kuq është zbatuar hetim në treg, posaçërisht në pjesën e përparimit të bashkëpunimit me kompani lokale si dhe testimin e interesit për vullnetarizim dhe participim në punën e Kryqit të Kuq të RM-së.**

Hetimi i zbatuar në treg paraqet bazë kaluese për parashikim të interesit të sektorit korporativ për përkrahjen e qëllimeve humanitare të Kryqit të Kuq.

Rezultatet e marrura nga hetimi i sektorit për biznes i zbatuar në mars të vitit 2008 në Maqedoni, ku morën pjesë 151 ndërmarrje tregon se:




- 20% nga të anketuarit kanë theksuar se janë mirë të njohtuar me aktivitetet të cilat i ndërmerr Kryqi i Kuq në Republikën e Maqedonisë.

Në bazë të çështjes e cila ka të bëjë me aktivitetet themelore të Kryqit të Kuq në RM-së më së shumti është përmendur aktiviteti primar i Kryqit të Kuq – ndihma humanitare.

- Përgjigjet nga hetimet treguan tendencë pozitive dhe pajtueshmëri të lartë se Kryqi i Kuq i RM-së është organizatë e cila është e përkushtuar në qëllimet për të cilat angazhohet..




- Reputacion i lartë të cilin Kryqi i Kuq e kënaq në Republikën e Maqedonisë shihet në 88% të përgjigjeve pozitive nga të anketuarit nga sektori korporativ në Maqedoni.

- Në numër më të madh nga rastet 60% nga të anketuarit kanë cekur se do të kishin donuar në organizatë humanitare nëse saktë janë të njoftuar me atë për çka do të kishin shfrytëzuar mjetet, kurse 48 % nga të anketuarit kanë

cekur se do të kishin donuar kur do të kishin më shumë mjete finansiare.

- Vetëm 7% nga numri i përgjithshëm i kompanive kanë njëfar plani apo programi për bashkëpunim me sektorin joqeveritar, përkundrazi 68 % të cilët nuk kanë program të atillë por as që kanë menduar për asisoj.

- Shumica e kompanive (64%) kanë donuar nga disa herë apo mjete në të holla në qëllime humanitare, 7% nga ata kanë donuar vetëm një herë, kurse 8 % donojnë vazhdimisht.

- Për pjesën më të madhe të ndërmarjeve të ankeuara (59%) pasqyra publike e organizatës humanitare është në vend të parë gjatë sjelljes vendimit për bashkëpunim me atë, kurse menjëherë vijon edhe shkalla e informimit për aktivitetet e organizatës humanitare.




- Pjesa më e madhe e ndërmarjeve (70%) janë të prirë kah përkrahja e projektit konkret të Kryqit të Kuq, përderisa 25% nga ata do të kishin përkrahur më shumë aktivitete të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

- Pjesa më e madhe e të anketuarve të cilët ishin pjesë nga hetimi nuk janë të njoftuar me ligjin për sponzorime dhe donime. Rreth 35% nga të pyeturit kanë theksuar se janë të njoftuar me këtë ligj.

- Për kyçje eventuale në aktivitete të ardhëshme të KKRM-së përgatitshmëri kanë theksuar 38.4% nga të pyeturit dhe atë 24,5% me përkrahje finansiare dhe 13,9% si vullnetarë. Papërgatitshmëri absolute kanë shprehur 10,6% nga të pyeturit.



Kur kthehemi në vitin 2008 që t'i shumojmë rezultatet të cilat u arritën në pjesën e zhvillimit dhe politikën kadrovike të Kryqit të Kuq të RM-së, mund të potencohen disa momente karakteristike në realizimin e tyre.

### Zbatimi i aktiviteteve zgjedhore në organizatat komunale të Kryqit të Kuq të RM-së dhe mbajtja e Mbledhjes konstituive zgjedhore të Kryqit të Kuq të RM-së për periudhën mandatare të vitit 2008-2012

Këshilli ekzekutiv i Kryqit të Kuq të RM-së në fillimin e vitit 2008, i fitoi të gjitha dokumentet e nevojshme për realizim të suksesshëm të aktiviteteve të shënuara për zbatimin e aktiviteteve parazgjedhore dhe zgjedhore, janë me qëllim që të zbatohet politika e shënuar e Kryqit të Kuq të RM-së.

Njëkohësisht posaçërisht duhet të theksohet realizimi i evidentimit të anëtarëve të Kryqit të Kuq ndarazi në çdo organizatë komunale, çka ishte një ndër parakushtet kryesore për evidentim dhe pranim të anëtarëve të mundshëm për përbërjen e Kuvendit të Kryqit të Kuq të RM-së në mandatin katër vjeçar të ardhëshëm. Në kohën gjatë zgjedhjeve iu kushtua rëndësi respektimit të kriteriumeve të vërtetuara për anëtarët e propozuar të Kuvendit të Kryqit të Kuq të RM-së.




## STRATEGJIA PËR VULLNETARIZËM

Puna e Kryqit të Kuq të RM-së bazohet në aktivitetin e vullnetarëve të shumtë të organizatës. Për shkak të modernizimit dhe përparimit të mëtejmë të aktiviteteve të këtij plani, Këshilli ekzekutiv i Kuvendit të Kryqit të Kuq të RM-së, solli Strategjinë për vullnetarizim e cila e rregullon këtë veprimtari të posaçme dhe të rëndësishme për punën e organizatës. E njejta ishte promovuar më 04.12.2008.



## PUNA E KUVENDIT TË KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Kuvendi i Kryqit të Kuq të RM-së, gjatë vitit 2008 mbajti 2 mbledhje të rregullta në pajtueshmëri me programin për punë në vitin 2008 dhe një mbledhje Konstituive zgjedhore për periudhen mandatare të vitit 2008-2012. Në mbledhjet e Kuvendit të Kryqit të Kuq të RM-së, u punua me 26 pika të propozuara dhe të fituara në rendin ditor.

## PUNA E KËSHILLIT EKZEKUTIV TË KUVENDIT TË KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Këshilli ekzekutiv i Kuvendit të Kryqit të Kuq të RM-së, në periudhën raportuese mbajti 11 mbledhje, nga të cilat gjashtë nga përbërja e vjetër dhe pesë në përbërjen e re të Këshillit ekzekutiv.

| Mbledhje | 30. | 31. | 32. | 33. | 34. | 35. | 1. | 2. | 3. | 4. | 5. | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i pikave në rendin ditor | 30 | 26 | 23 | 16 | 17 | 2 | 2 | 17 | 23 | 17 | 12 | 184 |
| Vendime | 17 | 8 | 6 | 7 | 7 | 1 | 1 | 8 | 11 | 8 | 10 | 84 |
| Informacione | 7 | 10 | 10 | 8 | 7 | 1 | 1 | 8 | 5 | 6 | | 63 |
| Zgjedhje/Emërtime | | | 1 | | | | | | 1 | 1 | | 3 |
| Dokumente strategjike | | | | | | | | 1 | | 1 | 1 | 3 |
| Raporte/Programe | 1 | 4 | 2 | | 1 | | | | 3 | | | 11 |
| Rregullore | 3 | 2 | 4 | 1 | 2 | | | | | 1 | 1 | 14 |
| Plane | 1 | | | | | | | | 3 | | | 4 |
| Kërkesa | | 2 | | | | | | | | | | 2 |

## KOMISIONI PËR ZHVILLIM DHE ÇËSHTJE KADROVIKE

Komisioni për zhvillim dhe çështje kadrovike në periudhën raportuese mbajti 4 mbledhje. Në mbledhjet e komisionit, anëtarët diskutuan në 14 pika.

## PUNA E TRUPAVE PUNUESE TË KËSHILLIT EKZEKUTIV TË KUVENDIT TË KRYQIT TË KUQ TË RM-së

Gjatë vitit 2008 të gjitha trupat e përhershëm dhe të përkohshëm të Këshillit ekzekutiv të Kuvendit të Kryqit të Kuq të RM-së, me dinamikën e planifikuar i realizuan aktivitetet dhe në pajtueshmëri aktivitetet programore i mbajtën mbledhjet e tyre.

## QENDRA TRAJNUESE EDUKATIVE - QTE



Gjatë vitit raportues, mundësitë hapësinore dhe pajisja me të cilën disponon QTE, ishin të përbëra në funksion të Kryqit të Kuq të RM-së. Prej muajit maj e deri në fund të vitit 2008, në hapësirat e QTE u realizuan: kurset për edukim të ligjëruesve dhe demonstruesve nga ndihma e parë për vozitës, kurset për edukim të ligjëruesve nga ndihma e parë për organizata punuese si dhe edukim të vizitorëve të kursit për ndihmë të parë për organizata punuese nga teritori i qytetit të Shkupit.

**Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë ka kapacitete të zbatuara dhe të mbajtura mirë për promovim të së Drejtës ndërkombëtare humanitare (DNH), Parimeve themelore dhe vlerave humane në pajtueshmëri me nevojat e grupeve qëllimore të brendëshme dhe të jashtme**

Plani strategjik për diseminim 2008-2010
i prezentuar në takimin me sekretarët e organizatave komunale dhe para diseminatorëve të punëtorive për trajnim të diseminatorëve

Baza për përgatitjen e Programit për punë në vitin 2008

A e realizuam atë që e shënuam në Program?

## MBINDËRTIMI I RESURSEVE NJERËZORE PËR DNH



Janë mbajtur punëtori me diseminatorë me qëllim për njohje më të gjërë me qëllimet tematike nga lëmia e DNH-së. Kujdes të veçantë u përkushtua në punën me grupe të posaçme qëllimore të dëgjuesve, nëpërmjet mjeteve dhe metodave përkatëse për zbatimin e orës diseminative dhe njohje me dokumentin strategjik për diseminim. Edhepse punëtoritë kishin për qëllim të zbatojnë trajnim të diseminatorëve tanimë të edukuar, është interesante që pjesëmarësit të cilët për herë të parë morën pjesë në këtë lloj trajnimi treguan motivim me vullnet të shprehur për pjesëmarje në aktivitete të diseminimit, kurse para së gjithash janë në përpunim të temave nga lëmia e DNH-së.




**"Personalisht dhe si pjesë e familjes së madhe humane ndjehem krenar në tregimet e realta e të drejtpërdrejta, mendime dhe shënime të diseminatorëve, intelektualëve, profesorëve, arsimtarëve, pedagogëve, psikologëve, sociologëve, juristëve, mjekëve, studentëve, të diplomuarve në sesionet diseminuese, trajnime në vitin 2008, për efektet dhe përvojat pozitive të përgatitshmërisë, çasjes, mënyrës, metodologjia dhe teknikat dhe mjetet e zbatuara për bartjen e njohurive dhe informacioneve për skeletin human, parime themelore dhe aktivitet të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, e Drjeta Ndërkombëtare Humanitare dhe Vlera humane si shtylla themelore të programit për diseminim të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë dhe në përgjithësi të KKRM dhe Lëvizjes. Me rënëdësi është se në ato tregime dhe shënime më së shpeshti është prezente e mësuara dhe ndikimi i ri dhe i zbatuar për ndryshime të vlerave pozitive në mjedisin, njerëzit, jetën dhe punën.**

**Për mua është me rëndësi që rrjedh një koncept zhvillimor i suksesshëm, i hapur për tregime kreative dhe mundësi dhe vullnetarë të rinjë, dhe i aftësuar dhe fleksibil për aktivitet të integruar interaktiv me struktura qeveritare dhe joqeveritare në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj.**

**Shpresoj se, kjo arritje me aktivitet strategjik qëllimor të zhvilluar dhe aktivitet të strukturuar për adaptim, do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhëshme".**

Ljupço Millkovski, vullnetar

# MONITORIM NË KOHËN GJATË SESIONEVE DISEMINUESE NGA DISEMINATORËT KOMUNAL



Gjatë vizitave të organizatave komunale, pjesëmarrja aktive në punëtoritë për trajnim dhe dorëzim të raporteve për diseminim, do të zbatohet selektim i diseminatorëve të cilët do të jenë të trajnuar për grupe specifike qëllimore.




**"NDRYSHIMET KLIMATIKE – SFIDË, POR EDHE OBLIGIM"** – moto me të cilën u shënua 8 Maji Dita Botërore e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe 8 – 15 maj

Shënimi qendror i 8 Majit u mbajt në selinë e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, me promovimin e triskës postale me pagesë plotësuese të botuar nga N.P. Posta Maqedonase.

Në organizim të Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit është organizuar ligjeratë për ndikimin e ndryshimeve klimatike nga ana e profesorit Mirko Tripunoski nga FON (FSHP), që u mbajt në ShOH "Dare Xhambaz".

Organizatat komunale të Kryqit të Kuq në shënimin u kyçën me aktivitete të veta siç janë: ligjeratat e diseminatorëve në mjedise të ndryshme, akcione të organizuara për dhurimin e gjakut, mbjellja e fidaneve për mbrojtjen e ambientit jetësor, hapja e garave nga ndihma e parë etj.




ASTRA 17D
симбол за
ПОЧИТ

## Nga burimi i organizatës komunale

Shënimi i Javës së Kryqit të Kuq në Organizatën komunale të Kryqit të Kuq Prilep nuk u ndal vetëm në manifestimin publik, për rritjen dhe aktivimin e potencialit vullnetar të organizatës janë realizuar prezentime me temën: “Menaxhim me ndryshimet klimatike”, sesion diseminues për grup qëllimor – të papunësuar, me theksim të nevojës për rritje të potencialit vullnetar – “Kryqi i Kuq mundësi për të gjithë”, kurse njëkohësisht ishte realizuar edhe distribuimi aktiv i materialit propagandues nga ana e vullnetarëve të rinjë të Kryqit të Kuq Prilep.

## Trupi këshilldhënës për diseminim

Komisioni për diseminim i përkrahë raportet e planifikuara dhe i pranon për aktivitetet e realizuara edhe dokumentet e rëndësishme, çka paraqet sfidë edhe për përbërjen e re të Komisionit në periudhën mandatare 2008 – 2012.

## Përkrahje, bashkëpunim dhe partneritet

## Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

■ Përkrahja e vazhdueshme dhe bashkëpunimi me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) vazhdoi edhe në vitin kur delegacioni e mbylli zyrën e tij në Shkup. Në definimin e qëllimit specifik të planit vjetor për aksionin e Kryqit të Kuq të RM-së, në fokusin e KNKK janë kapacitetet operative, me konstatim se:

Shoqata nacionale ka kapacitete të sigurta koperative në strukturën me përgjegjësi direkte për zhvillimin e mëtejshëm të programit për diseminim. Kapacitetet diseminuese të ShN për promovimin e brendshëm dhe të jashtëm tanimë janë të mbindërtuara, duke e kyçur trajnimin e posaçëm për DNH. ShN ka mjete të përpunuara mirë për planifikimin dhe vlerësimin e nevojave me strategji të qartë për qëndrueshmëri

■ Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë realizon sa më shumë kontakte me kuadrin arsiomoro-studiues nga institucionet e larta arsimuese nga lëmia e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, promovim i së cilit në ardhmëri do të intensifikohet nëpërmjet aktiviteteve të Komitetit nacional për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare në Republikën e Maqedonisë. Shoqata nacionale është bartëse e aktiviteteve në Plan – Programin e përgatitur për masa për edukim dhe diseminim në të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe në mbrojtjen e ëmblemës së Kryqit të Kuq, Gjysëmhënës së Kuqe dhe Kristalit të Kuq. Qëllimi kryesor i Programit është zgjerimi i diturisë për parimet themelore dhe lëvizja e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, si dhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Kryqin e Kuq të RM-së dhe sjellja e Ligjit të ri për Mbrojtjen e ëmblemës së Kryqit të Kuq, Gjysëmhënës së Kuqe dhe Kristalit të Kuq, me qëllim të implementimit të plotë të DNH.

Komitetin nacional e përbëjnë përfaqësues nga ministritë për: punë të jashtme, mbrojtje, drejtësi, arsim dhe shkencë, kulturë, shëndetësi, financa, punë dhe politikë sociale, punë të brendshme, Sekretarijati gjeneral i Qeverisë dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë .

■ Kyçja e kuadrit të profesorëve të institucioneve të larta arsimore në aktivitete të këtilla dhe të ngjajshme, është me interes të posaçëm, sepse në këtë mënyrë u zbatua bashkëpunim me institucione të larta shkencore. MANU organizoi debat shkencor me temë: “Standardet europiane për të drejtat e njeriut dhe implementimi i tyre në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë”, që u mbajt më 18 nëntor të vitit 2008, për të cilën ishte i ftuar Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë. Në kuadër të tezës organizative “Të drejtat e viktimave nga përleshjet luftarake”, Kryqi i Kuq i RM-së, nëpërmjet punës së përbashkët me doc. d-r Dushko Stojanovski nga univerziteti i parë privat FON (FShP), përgatiti rezime me temë “Koleracioni i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”.

## Perspektiva

**Me nënshkrimin e Memorandumeve për bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe joqeveritare hapen mundësi për realizimin e qëllimeve strategjike.**

## Zhvillimi i programeve shëndetësoro - preventive në përshtatje me nevojat e bashkësive

### Java për luftën kundër sëmundjeve të zemres dhe enëve të zemrës

**Njoftohuni me rrezikun! Mënyra e Juaj e jetesësështrë mbrojtja më e mirë e Juaj nga sëmundjet e zemrës dhe enëve të zemrës!**

Edukimi i popullatës për informimin në kohë dhe të drejtë për sëmundjet jongjitës dhe kronike, ku bëjnë pjesë edhe sëmundjet e zemrës dhe enëve të zemrës paraqet aktivitet tradicional të Kryqit të Kuq të RM-së. Për atë qëllim u përgatit material informativo - edukues, kurse organizatat komunale të Kryqit të Kuq mbajtën ligjerata të tipizuara, tribuna, ngjarje mediumi, manifestime për ngritjen e vetëdijes publike për domethënien apo rëndësinë e mënyrës së shëndoshë të jetës dhe nevoja nga kontrolli në kohë i shëndetit personal.

### Java kundër kancerit

**Mendohuni edhe një herë! Çka bëni me shëndetin Tuaj?**




Kryqi i Kuq i RM-së gjatë Javës për luftë kundër kancerit ndërmori aktivitete me qëllim që të rritet informimi në kohë dhe i drejtë i mobilizimit të individëve dhe bashkësisë për redukim të rrezikut nga sëmundjet, si dhe mundësitë për zbulimin e tyre të hershëm dhe mjekim përkatës.

Me atë rast, organizatat komunale të Kryqit të Kuq distribuan material informativo - edukues, organizuan ligjerata për grupe specifike qëllimore, tribuna me institucione dhe organizata të ndryshme me qëllim zgjërimin e njohurive për mundësitë nga preventimi i kancerit dhe zbulimit të tij të hershëm.

### Java për luftë kundër HIV / SIDA

**Stop për SIDA. Mbajeni premtimin! Partner në aktivitetet e bashkësisë! Partner në realizimin e Aliancës globale për HIV ! Partner me njerëzit të cilët jetojnë me HIV!**

Qëllimi i fushatës për luftë kundër HIV/SIDA ishte që të potencohet nevoja nga ndërmarrja individuale e iniciativës, ndërmarrja e udhëheqjes në mjedisin e vet, në luftën kundër stigmatizimit dhe diskriminimit në bashkësinë e vet, në sigurimin për përkrahje dhe kujdesje për personat të cilët jetojnë me HIV/SIDA.

Kryqi i Kuq i RM-së punon vazhdimisht në edukimin e informimit të popullatës për preventimin e HIV, me vëmendje të veçantë për grupet me sjellje të rrezikshme, si dhe ndërtimi i kapaciteteve të edukimit moshor për HIV/SIDA në grupe të ndryshme qëllimore.

Organizatat komunale të Kryqit të Kuq posaçërisht i intensifikuan aktivitetet informativo - edukuese gjatë kohës së Javës për luftë kundër HIV/SIDA kur gjatë sesioneve edukative në klubet e të rinjëve dhe shkollave, mediumeve dhe gjarjeve muzikore në vende publike u informua popullata për preventimin e HIV/SIDA, destigmacioni i njerëzve me HIV pozitiv dhe kujdesi për ata.




### Klube për promovimin e gjidhënies optimale dhe ushqimi në kohë për foshnje dhe fëmijë të vegjël

Kryqi i Kuq i RM-së në vitin 2008 filloi me realizimin e projektit Klube për promovimin e gjidhënies optimale dhe ushqim i foshnjeve në dy organizata komunale: Ohër dhe Koçanë. Projekti kishte për qëllim që ti edukojë nënat për gjidhënie të drejtë dhe ushqim në kohë për foshnjet dhe fëmijët e vegjël. Për atë qëllim ishin informuar klube në shtëpitë shëndetësore dhe ambientet e Kryqit të Kuq, ku ishin organizuar punëtori edukative. Nëpërmjet punës teorike dhe praktike me nënat u promovua koncepti i gjidhënies ekskluzive dhe rëndësia e të ushqyerit të shëndetshëm në kohë për fëmijët e tyre. Në kuadër të projektit u përgatit edhe broshurë në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe - gjidhënie e suksesshme dhe ushqim në kohë dhe u ndërtuan kapacitetet për edukim të ardhshëm moshatar (nënë - e nënës) dhe përkrahja në klube.




Në organizatën komunale të Kryqit të Kuq Ohër projekti u realizua me përkrahje financiare nga Kryqi i Kuq i Spanjës dhe u mbajtën 20 punëtori ku morën pjesë 196 nëna.

Në organizatën komunale Koçanë projekti u implementua me përkrahje financiare të Kryqit të Kuq kanadez dhe 110 nëna ishin të edukuara në 16 punëtori.

# Përmirësimi i kontrollit me tuberkulozin në R. e Maqedonisë




### 1.Organizimi i akcioneve fluorografike me qëllim zbulimin aktiv të rasteve me tuberkulozë

Qëllimi kryesor i këtij projekti është zbulimi aktiv i rasteve me tuberkulozë mes grupeve të cilët janë nën rrezik të posaçëm për sëmurje me tuberkulozë siç është popullata rome dhe rritja e përqindjes së rasteve të shëruara me sukses nga kjo sëmundje.

Për nevojat e projektit ishin përpunuar broshura informativo – edukuese për tuberkulozë "Çka është tuberkuloza?" dhe poster "Informohu për tuberkulozën!".

Projekti filloi me realizim në Prilep dhe përfundoi mjaft me sukses me përfshirje të 1254 përfaqësuesve të popullatës rome. Me aksionet fluorografike në Manastir u realizuan 1024 inçizime fluorografike. Në Strumicë do të realizohen gjatë muajit maj të vitit 2009.

### 2.Përpunimi i planeve strategjike dhe operative të vetqeverisjes lokale

Qëllimi kryesor i projektit është përpunimi i planeve aksionale lokale për përmirësimin e kontrollit me tuberkulozin në nivel lokal dhe përvetësimi i të njejtëve nga ana e këshillit të komunave të përfshirë me projektin. Kryqi i Kuq ka rolin e fascilitatorit në krijimin e këtyre planeve operative strategjike. Gjatë realizimit të këtij projekti ZHPB (zhvillim i përbashkët i bashkësive).

Projekti filloi me realizimin gjatë vitit 2007 në tre komuna Kërçovë, Veles dhe Tetovë. Planet lokale të përpunuara për kontrollë të tuberkulozit ishin të përvetësuara me sukses nga ana e këshillit të komunave.

Gjatë vitit 2008 ishin të përfshira tre organizata të reja komunale të Kryqit të Kuq Strumicë, Gostivar dhe Prilep. Projekti është në fazën përfundimtare – përpunimi i aksioneve lokale me varg aktivitetesh të cilat iu paraprinë si formimi i ekipeve lokale, zbatimi i hetimit në teren dhe realizimi i punëtorive në grupe të mëdha. Menjëherë pas krjimit të tyre të njejtit do të jenë të dorëzar në këshillin e komunave.

# Zvogëlimi i dëmit nga përdorimi i drogave

Projekti për zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave u realizua në tre OKKK Prilep, Veles dhe Kërçovë.

Ky program është kahëzuar kah zvogëlimi i pasojave dëmtuese nga përdorimi i drogave, kurse para së gjithash kah zvogëlimi i rrezikut nga HIV/SIDA, hepatitis B dhe C dhe nga infeksione të ndryshme që barten nëpërmjet gjakut dhe seksit, mbidozimi dhe pasoja të tjera për shëndetin dhe dëme sociale. Gjatë vitit 2008 në të tre qendrat u arritën rezultatet që vijojnë:

- Janë distribuar gjithsej 2820 gjilpëra dhe 2459 shprice
- Janë ndarë gjithsej 1374 kondomë (prezervativë) pa pagesë
- 218 shërbime medicinale si dhe këshilla dhe edukim për HIV/SIDA, hepatit dhe infeksione që barten nëpërmjet gjakut dhe seksit, këshillim për testim pa pagesë për HIV/SIDA, edukim për injektim të sigurtë dhe marrëdhënie të sigurta seksuale të klientëve dhe partnerëve të tyre, këshilla për efektet e dëmshme nga përdorimi i drogave dhe informimi për llojet e trajtimit.
- 196 shërbime sociale, informim dhe këshillim nga punëtori social
- Shërbime dhe këshillime nga personi juridik

Për nevojat e projektit ishte përgatitur edhe broshurë informative "Zvogëlimi i pasojave të dëmshme nga përdorimi i drogave" me të cilën klientët do të mund të informohen për llojin e shërbimeve dhe ndihmën të cilët mund ta marrin në të trija qendrat dhe ku të drejotohen që ti marrin të njejtat.

Në kuadër të projektit, përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në qendrat ishin të realizuara edhe seminare për trajnim të përfaqësuesve nga qendrat shëndetësore dhe sociale, policia, vetqeverisja lokale dhe institucione tjera të cilat janë të involvuara direkt apo indirekte në implementimin e aktiviteteve programore të parapara me këtë projekt.



# Sëpari, në kohë, me kualitet, me aftësi, human...
# Ndihma e parë shpëton jetë

## Model  i ri i ndihmës së parë

ЦKryqi i Kuq i RM-së është organizatë e cila gjatë kohë e zbaton me përgjegjësi dhe kualitet mësimin për ndihmë të parë për kandidatë për vozitës të automjeteve në pajtueshmëri me Ligjin për siguri në komunikacionin e rrugëve (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 54/2007) dhe aktet nënligjore të cilat pjesërisht e rregullojnë këtë problematikë.

Me qëllim që të sigurojë kualitet maksimal, Kryqi i Kuq i RM-së vazhdimisht e përparon organizimin e mësimit, bashkëpunon me ente kompetente në vend, e akrediton edukimin e ligjëruesve, e modernizon pajisjen për zbatimin e mësimit dhe mundëson lidhje rrjetore me Organizatat komunale të Kryqit të Kuq.

Risitë në qasjen e organizatës të cilat Kryqi i Kuq i RM-së i ndërmer gjatë vitit 2008, nënkupton sjelljen e akteve të reja interne – rregullore.:

- Rregullore për aftësimin e kandidatëve për vozitës të automjeteve me përmbajtje nga programi mësimor për dhënien e ndihmës së parë personave të lënduar në aksident trafiku.
- Rregullore për aftësimin e ligjeruesve dhe diseminatorëve për përmbajtjet e programit mësimor për dhënien e ndihmës së parë presonave të lënduar në aksident trafiku.

Në pajtueshmëri me ato rregullore u zbatuan 8 cikle edukative në të cilat ishin të trajnuar 143 ligjerues dhe 82 demonstratorë për mbajtjen e mësimit nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës të automjeteve.

Përmabjtjet dhe kohëzgjatja e mësimit nga ndihma e parë ishin të modifikuara dhe të përmirësuara si dhe mënyra e evaluimit të diturisë dhe aftësive të hasura nga ndihma e parë. Evidentimi elektronik i mësimit, si dhe mundësia për testim kompjuterik të kandidatëve ishte përpunuar me qëllim që të përmirësohet objektiviteti dhe transparenca në punë.

Modeli i ri i ndihmës së parë ishte promovuar solemnisht më 24.10.2008 ku para përfaqësuesve të institucioneve qeveritare, mediumeve, kuadrit profesional dhe vullnetar të Kryqit të Kuq dhe ishin prezantuar doracakët e ri edukativ: Ndihma e parë në rrugët dhe Ndihma e parë në vendin e punës.



## Ndihma e parë për kandidatë për vozitës - sigurimi në rrugë nuk është rastësisht!

Kryqi i Kuq i RM-së është kyçur aktivisht në përcaktimin strategjik për rritjen e sigurisë në rrugë me përforcim të kujdesjes paraspitalore të të lënduarve në fatkeqësi trafiku nëpërmjet ngritjes së vetëdijes së vozitësve dhe edukimin e tyre për dhënien e ndihmës së parë në rrugë në kohë dhe me kualitet.

17.954 kandidatë janë vozitës të automjeteve dhe ishin të trajnuar me sukses për ndihmë të parë në rast të aksidentit rrugor në 34 organizata komunale të Kryqit të Kuq gjatë vitit 2008.

## Ndihma e parë në vendin e punës - mjedis për punë të sigurt dhe të shëndoshë



Zhvillimi i trajnimit për ndihmë të parë në vendin e punës për Kryqin e Kuq të RM-së është me rëndësi të pavlerësueshme sepse i njëjti për kohë të shkurtë e rrit sigurimin në vendin e punës dhe e rrit sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

Kryqi i Kuq i RM-së në vitin 2008 përgatiti programe të ndryshme ekstenzive për ndihmë të parë në vendin e punës, në pajtueshmëri me rrezikun në vendin e punës apo detyrën punuese. U soll edhe Rregullore e re për realizimin e mësimit në kurs nga ndihma e parë në organizata punuese dhe u përgatit material edukativ – doracak Ndihma e parë në vendin e punës. Për edukim të 46 ligjeruesve për këtë lloj të mësimit ishin organizuar 2 cikle të mësimit.

Në vitin 2008 1.100 të punësuar nga sektori publik dhe privat vizituan mësim në organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit dhe me sukses u trajnuan për dhënien e ndihmës së parë në vendin e punës.

## Gara nga ndihma e parë



Kryqi i Kuq i RM-së tradicionalisht organizon dhe realizon garë shtetërore nga ndihma e parë për popullatën e re dhe në mënyrë edukativo – argëtuese e promovon rëndësinë e ndihmës së parë.

Gara e 17-të me rend nga ndihma e parë u mbajt më 07.06.2008 në Manastir dhe aty morën pjesë 23 ekipe të organizatave komunale të Kryqit të Kuq dhe një ekipë revijale (ekipi i KK të Qytetit të Shkupit i cili merr pjesë në garën nga ndihma e parë mes kryeqyteteve nga shtetet e Ballkanit).

Në manifestimin përskaj vendeve të punës nga ndihma e parë, ishin shtuar edhe vende tjera të punës me karakter garues-argëtues.

Pas rezultateve të shpallura nga gara e ndihmës së parë vendin e parë e fitoi ekipi nga Manastiri, vendin e dytë Kisella Voda, kurse vendin e tretë ekipi i Çairit.

## Dita botërore e ndihmës së parë -Ndihma e parë shpëton jetën



Të gjithë njerëzit janë më pak apo më shumë të mjeruar, por të gjithë posedojnë aftësi të mësojnë që ta japin ndihmën e parë me qëllim që të mbrohet jeta e dikuj. Kjo është porosi kyçe nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe dhe Kryqit të Kuq të RM-së për "Ditën botërore të ndihmës së parë ", që ka për qëllim të ngritet vetëdija publike për rolin e ndihmës së parë në preventimin nga lëndimet dhe shpëtimin e jetës së njeriut.

Më 13 shtator të vitit 2008, Kryqi i Kuq i RM-së dhe pjesë e organizatave komunale me kuadrin e tij profesional dhe vullnetarë zbatuan aktivitete të shumta promovuese: trajnime demonstruese për dhënien e ndihmës së parë, distribuimin e materialit edukativ, ngjarje nga mediumet, simulime të lëndimeve të mundshme në fatkeqësi rrugore dhe tregim i vargut human për shpëtim, tregim dramatik të dilemave të mundëshme te secili njeri gjatë dhënies së ndihmës së parë, anketa dhe kuize me të cilat qytetarët e RM-së patën rastin që ta testojnë dhe freskojnë diturinë e tyre për ndihmë të parë.

Kryqi i Kuq i RM-së dhe Kryqi i Kuq i qytetit të Shupit me rastin e " Ditës botërore për ndihmë të parë " filloi fushatën për promovimin e ndihmës së parë - Ndihma e parë shpëton jetë. Për promovimin e fushatës u përgatitën flaerë, siti llajt postere, bilborde, paraqitje në mediume dhe video spot me qëllim që të depërtojë te pjesa më e madhe e popullatës në RM dhe të drejtohet kah nevoja e njohjes së ndihmës së parë në jetën e përditshme.

## Lidhje rrejtore në lëminë e ndihmës së parë

Kryqi i Kuq i RM-së në vitin 2008, me përkrahje finansiare Kryqi i Kuq i Spanjës filloi me implementimin e projektit Lidhje rrjetore në lëminë e ndihmës së parë. Projekti i cili do të zhvillohet në cikle njëvjeçare ka për qëllim që ti stimulojë organizatat komunale të Kryqit të Kuq që të bejnë analiza serioze në gjendjen e tashme dhe të produktojnë çasje më të organizuar për rekrutimin e vullnetarëve, bashkëpunim me organizatat tjera (krijim i lidhjeve lokale operative) dhe dhënie të shërbimeve vullnetare nga lëmia e ndihmës së parë. Në vitin 2008 në ciklin fillestar u kyçën tre organizata komunale të Kryqit të Kuq; Veles, Koçanë dhe Kavadar, Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit dhe organizata komunale të Kryqit të Kuq në Shkup. Nëpërmjet mbledhjeve koordinative projekti mundësoi që të nxitet këmbimi i përvojave, ndarja e informacioneve të rëndësishme dhe krijimi i çasjeve inovative në aktivitetet vullnetare nga ndihma e parë. Nëpërmjet analizës së situatës, identifikimit të partnerëve nga bashkësia dhe mundësia për mobilizimin e resurseve, organizatave komunale të Kryqit të Kuq ndërmori aktivitete konkrete vullnetare për edukim nga ndihma e parë në grupe të ndyshme qëllimore (penzionerë, shoqata të grave, popullatë të fëmijëve nga çerdhet etj.)

Në këtë mënyrë u njohën përvojat më të mira të cilat mëtej dhe më gjërë do të zbatohen në shoqatën nacionale dhe do të shërbejnë për botimin e Doracakut për përvojat më të mira në lëminë e aktiviteteve vullnetare nga ndihma e parë.




# Ndarja e mirënjohjeve për dhurues të gjakut të zgjedhur nga Kryetari i shtetit

Më 14 mars të vitit 2008, Kryetari i Republikës së Maqedonisë z. Branko Cërvenkovski në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, me rastin e 17 marsit organizoi ndarje solemne në pasqyrë shtetërore “Medalje për merita për Maqedoninë” pesë dhuruesve të gjakut, dhe atë Sllobodan Cenovit, Boris Janevit, Ramadan Telkiut, Milivoj Jankovskit dhe Aco Aleksovskit.

# 17 marsi

## - Dita e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë




Më 17 mars të vitit 2008, u mbajt Mbledhje solemne në Kuvendin e  Kryqit e Kuq të Republikës së Maqedonisë me rastin e Ditës së themelimit të Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Ditës së dhurimit të gjakut. Përskaj fjalimit që e mbajti Kryetari i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë D-r Jovan Damjanoski, përfaqësues i Ministrisë së shëndetit i promovoi beneficionet për përdorimin e mbrojtjeve të caktuara shëndetësore të dhuruesve të gjakut të cilët kanë dhuruar gjak mbi 10 herë.

U ndanë shpërblime për tre OKKK më të suksesshme Krushevë, Shtip dhe Vinicë në dhurimin e gjakut të vitit 2007. Krusheva në vitin 2007 ishte e shpallur si qyteti më human.

Shpërblimin e mori Kryetarja e komunës së Krushevës Lefkija Gaxhoska. U nda mirënjohje post’humane “Medalje e artë e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë” Toshe Proeskit për kontributin e tij në misionin human të Kryqit të Kuq.



# Edukimi i motivuesve për dhurim të gjakut

Në periudhën prej 29 maj deri më 1 qershor të vitit 2008 në organizim të Klubit të dhuruesve të gjakut të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë u mbajt seminar për edukim të motivuesve për dhurim vullnetar të gjakut.

Në seminarin morën pjesë 20 përfaqësues të klubeve të dhuruesve të gjakut pranë OKKK nga Shkupi, Kumanova, Shtipi, Manastiri, Velesi, Tetova dhe Ohri, si dhe përfaqësues nga ministria e shëndetësisë të Republikës së Maqedonisë, Kryqi i Kuq i Shqipërisë, Kryqi i Kuq i Bullgarisë, Asociacioni i dhuruesve vullnetar të gjakut të Italisë (AVIS) dhe nga shoqata humanitare e hekuranëve të Sërbisë.

Nga puna e seminarit dolën edhe më shumë përmbyllje të përbashkëta:

• Të vazhdohet me promovimin dhe hapjen e më shumë klubeve të dhuruesve të gjakut pranë OKKK në qytetet më të mëdha dhe të jenë në koordinim të përhershëm me Klubin Qendror të dhuruesve të gjakut në Shkup;
• Të ruhet tradita për organizim të këtij lloji të seminareve për edukim të motivuesve në dhurim të gjakut me anëtarë të klubeve të dhuruesve të gjakut dhe të përdoren përvoja nga klubet tjera nga jashtë vendi;
• Mobilizimi i dhuruesve të gjakut të rinj me qëllim rekrutimin dhe kyçjen e tyre në aktivitete për dhurim të gjakut për angazhim të mëtejmë në dhurues të gjakut dhe motivues të përhershëm;
• Zgjerimin e bashkëpunimit, koordinim, këmbim i informacioneve dhe përvojave, lidhje informatike, shoqërim etj.

### Deklarata e Viçenco Guco përfaqësuesi i AVIS nga Italia

*E vlerësoj mënyrën në të cilën ishte zbatuar seminari dhe përmbajtjet të cilat ishin interesante, kurse fjalimiet individuale ishin në nivel të lartë. Nuk kishte asnjë çast ku vëmendja binte kah referenti, çdo temë ishte konstruktive dhe nuk ishte e rëndë për përcjellje.*

*Asgjë nuk ishte rastësisht, çdo gjë ishte e arsyetuar në mënyrë qartë, pa u lënë vend për interpretime të padrejta.*

*Përvojat dhe zhvillimet në dhurimin e gjakut në vendet pjesëmarrëse, gjithsesi do të mund të jenë në ndihmë edhe për Shoqatën tonë, në të gjitha nivelet.*

*Në AVIS jam dhurues i gjakut më shumë se 30 vite, përjetova shumë momente të përbashkëta në Shoqatë, momente të ballafaqimit në vet atë, por çdo herë përpiqesha të jem i kujdesshëm në të gjitha vështirësitë të cilat gradualisht na imponoheshin. E gjithë kjo më ndihmoi që më mirë ta kuptoj jetën, por kjo "avantura" e fundit ishte qershi në tortë.*

# Edukimi i studentëve për motivues në dhurimin e gjakut

Во рамкитеNë kuadër të projektit "Motivimi i popullatës së re për dhurim vullnetar të gjakut" i përkrahur finansiarisht nga Kryqi i Kuq i Kanadës, prej 24 deri 26 tetori në Strugë u mbajt seminar për edukim të motivuesve për dhurim të gjakut nga redni i popullatës studentore. Qëllimi i këtij projekti është që nëpërmjet edukimit të motivuesve moshatar të kontribuohet për numër të madh të dhurimit të gjakut të aksioneve të cilat organizohen në univerzitetet në Shkup, Tetovë dhe Manastir.

Dolën disa përfundime, dhe atë:

• Të formohen klube të motuvuesve të rinj për dhurim të gjakut në Shkup, Tetovë dhe Manastir;
• Të përpunohet plan aksionar për aktivitete për dhurim të gjakut të cilat organizohen në fakultetet pranë këtyre univerziteteve;
• Së bashku të përgatitet doracak për edukues të rinjë në dhurimin e gjakut;
• Të këmbehen përvoja ndërmjet vehti

Në kuadër të projektit "Lidhje rrejtore nga lëmia e dhurimit të gjakut – përmirësimit të dhurimit vullnetarë të gjakut të popullata e re", i përkrahur finansiarisht nga Kryqi i Kuq i Spanjës, më 29 nëntor të vitit 2008 u mbajt seminar njëditorë instruktiv për edukim të motivuesëve për dhurim të gjakut në rradhët e popullatës studentore.

Qëllimi i këtij projekti është që nëpërmjet edukimit të motivuesve moshatar të përfshijhen, motivohen dhe rekrutohet numër sa më i madh i studentëve, të rritet vetëdija e tyre për dhurim vullnetar të gjakut dhe të organizohen aksione kadrovike në të gjitha fakultetet pranë univerziteteve në Shkup, Tetovë, Manastir dhe Shtip.



Në kuadër të veprimtarisë socialo-humanitare gjatë vitit 2008 u implementuan aksione dhe aktivitete të rëndësishme me qëllim për zvogëlimin e mjerueshmërisë të popullatës  në bashkësitë, me zbatim të instrumenteve zhvillimore për përparimin e metodologjisë për punë në shoqatën nacionale.

# Zhvillim i përbashkët i bashkësisë- ZHPB

Kryqi i Kuq i RM-së në periudhën e vitit 2007-2008, nëpërmjet organizatave komunale të Kryqit të Kuq Kisella Vodë - Shkup, Dibër, Delçevë dhe Radovish programin ZHPB e implementoi në katër bashkësi të mjeruara rome. Si rezultat i trajnimeve të zbatuara të ekipeve ZHPB, vlerësimet e bëra për nevojat dhe prioritetet e vërtetuara të bashkësive, u realizuan aktivitetet që vijojnë me participientë qeveritarë dhe joqeveritarë dhe anëtarë të bashkësive:

■Në bashkësinë "Vrapçe" në Kisella Vodë – Shkup është instaluar rrjet përçues me gjatësi prej 600 metrash, është urbanizuar hapësirë në bashkësinë lokale si vend për socializim të popullatës, shoqërim, dhe mundësi për veprim të përbashkët në zgjedhjen e sfidave të ndryshme me të cilat ballafaqohet bashkësia, janë mbajtur punëtori nga lëmia e preventivës shëndetësore, planifikim të familjes dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

■Në bashkësinë "Pustevski endek" në Delçevë është shtruar rrugë për çasje në 265 m2; janë mbajtur punëtori nga lëmia për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe sëmundjeve ngjitëse; është formuar patrollë ekologjike e të rinjëve; janë vënduar dy trape për persona të sëmurë dhe të paralizuar deri në shtëpitë e tyre dhe është ndërtuar ujësjellës për të pirë ujë.

■Në bashkësinë "Vakov" në Dibër është hapur klub arsimoro – edukativ dhe informativ, ku janë mbajtur kurse për kompjutorë dhe zeje dhe janë edukuar gjithësej 40 të rinjë nga lëmia e informatikës dhe janë aftësuar 40 persona për kryerjen e zejeve (20 saldues dhe 20 ngjyrues). Gjithashtu janë mbajtur punëtori nga lëmia e preventivës shëndetësore dhe planifikim të familjes.

■Në bashkësinë "Shain maale" në Radovish u zbatua mësimi i shkrim leximit të popullatës, ku ishin të përfshirë gjithsej 76 persona nga bashkësia në moshë prej 10 – 25 vjet. Gjithashtu u mbajtën punëtori nga lëmia e preventivës shëndetësore dhe ekologjisë.

## Evaluimi i ZhPB

Me qëllim që të fitohet fotografi e qartë e aktiviteteve të realizuara të programeve ZhPB, të vërtetohen efektet, si dhe të nxjerren mësimet e mësuara të cilat do të kontribuojnë që në ardhmëri të përmirësohet zbatimi i mjeteve, u bë evaluimi i projekteve të implementuara në bashkësitë, si dhe në programin e ZhPB të shoqatës nacionale.

# "Për pleqëri dinjitoze"

Me qëllim që të zgjohen ndjenjat te njerëzit për kujdesin e nevojshëm të personave të vjetër dhe të pafuqishëm, posaçërisht te të rinjët që të krijohet shprehi për ndihmë dhe përkujdesje më të madhe për personat e vjetër me aktivitete të volitshme u shënua Java për kujdesjen e personave të vjetër. Organizatat komunale të Kryqit të Kuq organizuan aktivitete të shumta dedikuar për përkujdesje dhe ndihmën e personave të vjetër: ligjerim në shkolla, vizita në shtëpitë e personave të vjetër dhe shtëpitë e pensionistëve, matja e sheqerit në gjak dhe shtypjen e gjakut pa pagesë, takime të organizuara, tribuna, punëtori dhe ligjerata me tema aktuale, vizita e pleqëve dhe të personave të pafuqishëm në shtëpitë e tyre dhe ku është ndarë ndihmë në ushqim, veshje, mbulesa, barrëra, mjete për higjienë, matja e shtypjes së gjakut, ofrimi i shërbimeve të iméta për kënaqjen e nevojave të personave të moshuar, konkurse të shpallura: për banor më të vjetër, çift bashkëshortor me më shumë vite në bashkëshortësi dhe anëtar – aktivist më të vjetër në Kryqin e Kuq, konkurse për krijimtari arti dhe të letërsisë etj.



*..."Në organet e drejtorisë punova 30 vite dhe për këto 10 vite që jam në pension asnjëri prej tyre nuk më vizitoi. Vizita e Juaj shumë mirë më befasoi dhe ma zbukuroi ditën. Aktiviste në Kryqin e Kuq isha si e re dhe gëzohem që ende kujtohen në mua dhe nuk më harrojnë"...*

*Persa Maxhovska, aktiviste e mëparshme e OKKK - Kriva Pallankë*

## “Ndaj me të tjerët”

Nën moton “Ndaj me të tjerët” ishte e shënuar “Java e solidaritetit” tradicionale. Qëllimi ishte që të ngritet vetëdija e popullatës për përkrahje dhe ndihma e nevojshme ndërmjet vehti, si dhe të sigurohet ndihmë për kategoritë më të mjeruara të popullatës. Në kuadër të javës nëpërmjet organizatave komunale të Kryqit të Kuq u zbatua Akcion për mbledhje me të cilin u siguruan gjithsej 1538 kg. Shqim, 325 kg mjete për higjienë, 16.130 kg veshmbathje, 1561 palë mbathje dhe 1780 kg mbulesa. Ndihma iu nda 1840 rasteve sociale, si dhe në 5 institucione sociale.

## “Mendoni edhe për ne”

Me rastin e 16 Tetorit Dita ndërkombëtare e urisë u organizua fushatë nën moton: “Mendoni edhe për ne” me qëllim nxitjen e mendimit të përgjithshëm të popullatës për problemet e varfërisë, si dhe sigurim i ndihmës për kategoritë më të mjeruara të popullatës. Gjatë fushatës në nivel të shoqatës nacionale u siguruan gjithsej 840.535,00 denarë, 8290 kg ushqim të donuar dhe furnizuar nga mjetet, 6574 kg veshmbathje dhe e njejta është ndarë në institucione sociale dhe arsimore dhe në popullatën e mjeruar në vend.

## Zgjedhje më efektive e problemeve lidhur me përjashimin social dhe varfërinë e personave të vjetër

Më 20.11.2008 në Shkup në organizim të UNDP u mbajt Punëtori për persona të vjetër ku mori pjesë përfaqësues i Kryqit të Kuq të RM-së. Qëllimi i punëtorisë ishte që të përforcohet dialogu mes anëve kyçe të prekura për zgjedhje më efikase të problemeve lidhur me përjashtimin social dhe varfëri të personave të vjetër si një ndër grupet më të mjeruara dhe sociale në vend. Më 12.12.2008 u prezantuan rezultatet e aktiviteteve projektuese për personat e vjetër dhe personat me nevoja të posaçme.

## Trajnim për Përmirësimin e kontrollit të TB

Më 28 dhe 29.11.2008 u mbajt trajnim për Përmirësimin e kontrollit të TB në RM për punëtorë sociale dhe vullnetarë, në organizim të Institutit për sëmundje të mushkërive të bardha dhe tuberkulozit. Në seminarin mori pjesë përfaqësues i shërbimit profesional të Kryqit të Kuq të RM-së.




## Lufta kundër tregëtisë me njerëz

- Në bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale, kurse me përkrahje të Organizatës ndërkombëtare për migrime gjatë muajit mars u organizuan dy seminare për edukim të 33 përfaqësuesve të organizatave komunale të Kryqit të Kuq si koordinues të programit për luftë kundër tregtisë me njerëz. Qëllimi i edukimit ishte që të përforcohen kapacitet e Kryqit të Kuq të RM-së, çka do të paraqesë bazë kalimtare për veprim të ardhshëm në luftën kundër tregtisë me njerëz.

- Me rastin e 2 dhjetorit – dita botërore e ndërprerjes së robërimit, filloi shënimi edhe i “Javës për luftë kundër tregëtisë me njerëz” 2-9 dhjetor të vitit 2008, i cili është shpallur nga ana e Ministrisë për punë të brendëshme dhe Sekretariatit të komisionit nacional për luftë kundër tregëtisë me njerëz dhe migrimit ilegal. Qëllimi për shënimin e javës ishte që të rritet vetëdija publike tek qytetarët për rezikun nga tregëtia me njerëz. Si anëtar i Sekretariatit të komisionit nacional për luftë kundër tregëtisë me njerëz dhe migrim ilegal, Kryqi i Kuq i RM-së mbi 12 organizata komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit aktivisht u kyq në shënimin e parë të javës.

- Më 9 dhe 10 dhjetor të vitit 2008 Kryqi i Kuq i RM-së dhe Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit, në bashkëpunim me UNHCR dhe përkrahje të IOM, organizuan dy punëtori informativo edukative për kërkues të azilit dhe vullnetarë të Kryqit të Kuq, ku u prezantuan tema nga lëmia e preventivës shëndetësore, si dhe për tregëti me njerëz.

# Këmbimi i përvojave në luftën kundër tregëtisë me njerëz

■ Me ftesën e Kryqit të Kuq të Sërbisë më 10 qershor në Vranje, përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së morën pjesë në seminarin me temë: "Kontakt me viktimën e tregëtisë me njerëz - si të njihet dhe të reagohet ". Seminaret e këtilla paraqesin mundësi për këmbim të përvojave në planin e luftes kundër tregëtisë me njerëz mes dy shoqatave nacionale, me tendencë që bashkëpunimi i tillë të realizohet dhe të zhvillohet në periudhën e ardhëshme.

■ Më 25.11.2008 në Zagreb, përfaqësues i Kryqit të Kuq të RM-së mori pjesë në Tryezën e rrumbullakët me rast të prezantimit të aktiviteteve përfundimtare projektuese për luftë kundër tregëtisë me njerëz, në organizim të Kryqit të Kuq Kroat. Qëllimi i takimit ishte që të këmbehen përvoja të aktiviteteve projektuese me mundësi që të njejtat të implementohen në shoqatat e veta nacionale.

■ Në organizim të Ministrisë për pnnë dhe politikë sociale më 29.09.2008 u mbajt Tribunë publike me temën; "Lufta kundër tregëtisë me njerëz, përgjegjësi e shoqërisë maqedonase" ku morën pjesë përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së. Në debate të këtilla në nivel lokal u kyqën edhe organizatat komunale të Kryqit të Kuq Tetovë dhe Kavadar.

# Anëtarësi në PERCO

■ Më 17 dhe 18 prill të vitit 2008 në Beograd u mbajt mbledhja e PERCO (platforma për bashkëpunim të shoqatave europiane nacionale për të ikur, kërkues të azilit dhe emigrantë). Përfaqësues i Kryqit të Kuq të RM-së në mbledhjen i prezantoi aktivitetet e shoqatës nacionale për ndihmë të kërkuesve të azilit, program të cilin e implementoi Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit, si dhe për aktivitetet për luftë kundër tregëtisë me njerëz. Me aplikimin e dorëzuar për anëtarësim në PERCO, i cili ishte i shqyrtuar dhe përkrahur nga ana e këshillit drejtues, Kryqi i Kuq i RM-së e mori statusin e anëtarit mbikqyrës.

# Mbledhje ndërkombëtare për Migrime në rajonin e Mediteranit

Në organizim të të Kryqit të Kuq të Italisë, me përkrahjje të Qeverisë italiane nga 14 – 17 shkurti në Palermo, u mbajt Mbledhje ndërkombëtare për Migrime në rajonin e Mediteranit, ku morën pjesë përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së. Qëllimi i mbledhjes ishte që të këmbehen përvoja, të krijohen programe të reja që ti dilet në ndihmë kësaj sfide humanitare si dhe mobilizim i Shoqatave nacionale në bashkëpunim me Qeveritë nga rajoni për përgjigje hjumanitare të sfidave migruese.

# Iniciativa për formimin e Njësisë për Migrime

Në organizim të të Kryqit të Kuq të Austrisë nga data 26 – 28.05.2008 në Vienë u mbajt mbledhja për formimin e Njësisë për Migrime, ku mori pjesë edhe përfaqësues i Kryqit të Kuq të RM-së. Ky takim për shoqatën tonë nacionale, e cila që 13 vite i realizon aktivitetet që dedikohen për ndihmë dhe kujdesje humanitare të personave të përkujdesur dhe kërkuesve të azilit, ishte me rëndësi të veçantë për shkak të mundësisë për këmbim të përvojave me shoqatat tjera nacionale.

## Donacione

**Linje telefonike për donatorë: 070/075 dhe 077 143 400 dononi 100 denarë**

**Gjatë vitit 2008 nga tre linjet telefonike donatore janë siguruar gjithsej 237.000 denarë, me të cilat furnizohen 200 paketime me ushqim dedikuar për ndihmën e popullatës së mjeruar.**




■ S rezultat i bashkëpunimit afatgjatë të frytshëm me Kryqin e Kuq të Gjermanisë në Baden Virtemberg i cili në vazhdim realizohet që 16 vite, gjatë vitit ishte siguruar ndihmë humanitare e cila ishte e përbërë nga krevate spitali, ndihmëse invalidore, paisje medicinale, kompjutorë, sete kuzhineje, veshje etj. Në shumë të përgjithshme prej 88.400,00 euro dhe e njejta është e shpërndarë në institucione të shëndetësisë dhe sociale në vend, si dhe për nevojat e popullatës së mjeruar.

■ Kompania "Vest Impeks" nga Shkupi për realizimin e qëllimeve humanitare të Kryqit të Kuq të RM-së donoi ndihmë në 12.000 copa lecka kuzhineje, në vlerë prej 179.832,00 denarë dhe të njejtat janë ndarë në institucione sociale.

■ COLGATE Palmolive Adria siguroi 3000 pasta për dhëmbë, me çka dhanë kontribut të drejtëpërdrejtë në mobilizimin e popullatës për mbrojtje preventive shëndetësore.

■ Nga ana e Drejtorisë doganore të Republikës së Maqedonisë ishte siguruar ndihmë prej 2700 kg ushqim dhe veshëmbathje e re me vlerë prej 714.350,00 denarë dhe e njëjta është distribuar në institucione sociale.

.

Gjatë vitit 2008 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë ndërmori më shumë aktivitete në lëminë e përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave me plan të vendit dhe ndërkombëtarë, të cilat dalin nga Plani zhvillimor i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, Strategjia për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave me qëllim që ti lehtësojë pasojat, të sigurojë ndihmë dhe shërbime për popullatën e mjeruar të goditur nga katastrofat.



## QËLLIME TË PROMOVUARA STRATEGJIKE

Në shkurt u mbajt punëtori me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të Kuq, ku ishte prezantuar Strategjia për zhvillim të Kryqit të Kuq të RM-së në planin për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave.

## BASHKËPUNIM PARTNEROR

Në periudhën prej 26/28 – 11 – 2008 u mbajt punëtori me temën: “Vendi dhe roli i Kryqit të Kuq të RM-së në sistemin për menaxhim me kriza”. Punëtoria ishte e organizuar nga ana e Qendrës për menaxhim me kriza dhe Kryqit të Kuq të RM-së, me përkrahje nga Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq. Qëllimi i punëtorisë ishte që të përmirësohet komunikimi dhe koordinimi mes të gjitha subjekteve në sistemin për menaxhim me kriza.

## USHTRIME SIMULUESE

Në vitin 2008, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Qendra për menaxhim me kriza dhe Drejoria për mbrojtje dhe shpëtim, ishin organizatore të më shumë ushtrimeve ndërkombëtare simuluese, ku u treguan situata të ndryshme në rast të katastrofave, në Maqedoni dhe rajon, me qëllim që të përmirësohet komunikimi dhe koordinimi i planit vendor dhe ndërkombëtar. Në këto ushtrime morën pjesë përfaqësues nga Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë.





- Kryqi i Kuq i RM-së, Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit dhe Organizata komunale e Kryqit të Kuq Veles organizuan trajnim rajonal për Njësinë Republikane për përgjigje gjatë katastrofave dhe njësive për përgjigje gjatë katastrofave të Velesit, Manastirit, Ohrit, Kavadarit dhe Koçanit. Në trajnim morën pjesë gjithësej 80 pjesëmarrës, mes së cilëve edhe përfaqësues të Njësitit për helikopterë të Armatës së RM-së.

Qëllimi i trajnimit ishte që në praktikë të tregohen aktivitetet e ekipeve të Njësive për përgjigje gjatë katastrofave të Kryqit të Kuq të RM-së me institucionet qeveritare përgjegjëse për menaxhim me kriza.

- Në organizim të Organizatës komunale të Kryqit të Kuq Ohër me përkrahje logjistike nga Kryqi i Kuq i RM-së, në arenën sportive “Biljanini izvori” në Ohër u mbajt trajnim tregues për evakuimin e vizitorëve në rast zjarri, ku morën pjesë pjesëtarë të MPB-së, njësitë zjarrëfikëse, Qendra medicinale, ekipe nga OKKK – Ohër dhe agjencioni për sigurimin e sallës. Evakuimi është zbatuar në planin prej më parë të përpunuar për evakuim nga ana e Kryqit të Kuq të RM-së.

- Në organizim të Ministrisë për mbrojtje u mbajt trajnim për shpëtim, evakuim dhe përkujdesje të popullatës së mjeruar nga havari kimike të fabrikës në Veles, që u mbajt në Krivollak. Në këtë trajnim mori pjesë ekipi medicinal, logjistik dhe ekipi për shpëtim në ujë të Njësitit republikan për përgjigje gjatë katastrofave me mjete komplete materialo – teknike.



■ Në organizim të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë dhe Qendrës për menaxhim me kriza të RM-së, u mbajt trajnim simulativ 10 ditor QMK - 2008 për menaxhim me më shumë lloje të katastrofave në bashkëpunim me aleancën NATO dhe anëtaret e NATO. Në trajnim mori pjesë edhe Kryqi i Kuq i RM-së.

■ Me organizim të Qendrës për menaxhim me kriza u mbajt trajnim simulues me skenë - vërshim në rajonin e Shkupit, ku kontrolloheshte gjendja e përgatitshmërisë për menaxhim me katastrofa në të gjitha subjektet të cilat janë kompetente për situata të këtilla me krizë.

■ Pjesëmarje në Konferencën Planifikuese për Trajnim simulues në organizim të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim. Trajnimi u mbajt në periudhën pre 16/17/18/19.06.2008

■ Në Qendrën për menaxhim me kriza, në periudhën prej 22-31.10.2008 u mbajt trajnim ndërkombëtar Seesim - 08 (rrjet simulues për Europën Juglindore);

■ Federata ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, në bashkëpunim me Kqyqin e Kuq Kroat dhe Austriak, në periudhen prej 15 deri me 21 shator to vitit 2008 në Kroaci - Istra, organizuan ushtrime ndërkombëtare simuluese për anëtarët e



Ekipit rajonal për përgjigje gjatë katastrofave, të cilët kanë mbaruar kursin për pastrimin e ujit dhe sanitim. Nga Kryqi i Kuq i RM-së, morën pjesë katër anëtarë nga ekipi për pastrim të ujit të Njësitit republikan për përgjigje gjatë katastrofave.

## KURSE

■ Kryqi i Kuq i RM-së në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të qytetit të Shkupit dhe Organizatën komunale të KK Ohër mbajtën kurse për shpëtues në ujë, ku ishin të aftësuar gjithësej 46 persona.

■ Kryqi i Kuq i RM-së në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Austrisë prej 01 deri 08 maj të vitit 2008 organizoi trajnim - kurs rajonal për pastrimin e ujit, që u mbajt në Mariovë (Ura e Rasinbegut).

Në kursin morën pjesë përfaqësues të Kryqit të Kuq të Bullgarisë, Sërbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës.

■ Federata Ndërkombëtare organizoi kurs për teknologji informatike, ku Kryqi i Kuq i RM-së mori pjesë me një përfaqësues. Seminari kishte për qëllim, që pjesëmarrësit të njoftohen me pajisjen standarde të cilën Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe e përdor në kohën e misioneve.

■ Katër anëtarë nga ekipi për shpëtim në mal të Njësitit Republikan për përgjigje gjatë katastrofave, morën pjesë në kursin për shpëtues në mal në Kroaci. Qëllimi i seminarit ishte që ekipi të njoftohet me dituri të reja për shpëtim me teknika verore, zbatimin e punës me mundësi të organizimit të kurseve në Maqedoni.

■ Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe nga 20 - 29 maj në Mostar - B dhe H, organizoi trajnim, për përfaqësues të shoqatave nacionale të Kryqit të Kuq të Europës Juglindore. Me trajnimin e fituar pjesëmarrësit në trajnim bëhen anëtare të Ekipit rajonal për përgjigje gjatë katastrofave. Nga Kryqi i Kuq i RM-së morën pjesë dy përfaqësues.

■ Në periudhën prej 27 – 30.05.2008 në Bullgari u mbajt kurs për shpëtues në ujëra të shpejta. Kursi u mbajt në qytetin Kresna përskaj lumit Struma. Kryqi i Kuq i R. Maqedonisë për herë të parë me përfaqësues të vet mori pjesë në kurs të këtillë, që është me domethënie të madhe për fitimin e kuadrit të këtij lloji për edukim.

## PJESËMARRJE NË SEMINARE

■ Në periudhën prej 13 – 14.03.2008 Kryqi i Kuq i Bullgarisë në Llozen – Sofje organizoi seminar ku përfaqësues të Kryqit të Kuq të RM-së morën pjesë si instruktorë për përpunim të planit data – bazë për veprim.

■ Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe prej datës 26 – 30 qershor 2008 në Durrës, Republika e Shqipërisë organizoi seminar me temë: "Vlerësimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve". Në seminarin morën pjesë përfaqësues të shoqatave nacionale nga rajoni dhe më gjërë. Nga Kryqi i Kuq i RM-së morën pjesë tre përfaqësues të shërbimit profesional.

## NDIHMË PËR TË PËSUARIT NË RADOVISH



Në vitin 2008, Republika e Maqedonisë nuk ishte e shmangur nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, dhe njëashtu koha e keqe që e kaploi rajonin e Radovishit, shkaktoi dëme të mëdha materiale dhe humbje njerëzore.

Kryqi i Kuq i RM-së intervenoi me ekipe të veta të cilët e bënë vlerësimin për nevojat e të pësuarëve në Radovish, në bashkëpunim me shtabin për kriza të Komunës së Radovishit



Në bazë të vlerësimit të bërë nga ana e Kryqit të Kuq të RM-së dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit, u siguria ndihmë humanitare pët 30 familje të cilët ishin të qëlluara më shumë.

## Nxjerrje nga ueb kontakti në portalin e internetit të Kryqit të Kuq të RM-së

*"Të nderuar, para se gjithash do të doja t'ju uroj për Trajnimin metodik të treguar dhe të realizuar me sukses në Veles. Me sinqeritet, ishte shumë mësimtare, interesante, i treguar thjeshtë, i realizuar çuditërisht.*

*U kënaqa duke i shikuar veprimet e ushtruara, ekipet e përgatitura.*

*Duke u falenderuar për këtë trajnim fitova idenë që t'Ju shkruaj dhe t'Ju pyes se a do të kisha mundur të anëtarësohem në organizatën e Juaj dhe të bëhem pjesë e ekipit i cili punon në tërhjeqjen e personave të lënduar në rast të katastrofave.*

*Kam 26 vjet, jam nga Velesi dhe punoj në ARM si ushtar profesional.*
*Edhe njëherë urime dhe vazhdoni me punën e mëtutjeshme".*

**Nikollçe Çolloko**

**Të rinjët e Kryqit të Kuq të RM-së edhe më tej vazhdojnë të jenë bartës të aktiviteteve të shumta në teren të Shoqatës nacionale, si dhe një ndër iniciatorët e ngitësit të ideve për përmirësimin e efikasitetit të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Njëzërit kalendari tradicional i aktiviteteve dhe manifestimeve dhe programi për punë për vitin 2008 në kuadër të veprimeve programore, janë realizuar numër i madh i aktiviteteve në nivel nacional dhe lokal.**

## Reforma në punën e të rinjëve – forma të reja të organizimit të vullnetarëve të rinj

Pas analizës së zbatuar për punë të organizatave komunale të Kryqit të Kuq, Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit dhe Qendrës së Kryqit të Kuq të RM-së, u paraqit nevoja për reformë për punën e së rinjëve, gjegjësisht gjetja e formave të reja dhe atraktive për tërheqje, motivim dhe organizim të vullnetarëve të rinj, çka rezultonte me nevojën për përvetësimin e Rregullores së re për punë dhe organizim të të rinjëve të Kryqit të Kuq të RM-së. Në organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit, janë formuar 35 klube të vullnetarëve të rinj të Kryqit të Kuq, të cilët janë aktivisht të kyçur në aktivitetet për plotësimin e qëllimeve të shoqatës nacionale. Është formuar Këshilli i të rinjëve i përbërë nga përfaqësues të të gjitha klubeve të të rinjëve, të udhëhequr nga Kryetari i të rinjëve të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

## Mbledhje europiane për bashkëpunim me të rinjët e Kryqit të Kuq

Në Prill të vitit 2008 në Tuheljske toplice – Kroaci, u mbajt Mledhje europiane për bashkëpunim me vullnetarët e rinjë të Shoqatave nacionale, ku Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë mori pjesë me dy përfaqësues. Në mbledhjen ishin miratuar iniciativa për ndryshimin e rregullores për të rinj të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe, si dhe diskutimi për kahje globale për zhvillim të programeve të të rinjëve të Shoqatave nacionale. Në mbledhjen është zgjedhur përbërja e re e komitetit europian koordinativ për periudhën mandatare 2008 – 2010, ku për herë të dytë anëtarëson përfaqësues i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë..






Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të të rinjëve të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, kuse me iniciativë të vullnetarëve të rinjë nga organizatat komunale u mbajt kampi veror i të rinjëve nën emrin Kryq i Kuq 100 %.

Bëhet fjalë për kamp veror edukativ ku morën pjesë 45 të rinjë të ndarë në tre grupe dhe atë: Menaxhim me ciklin projektues, Tregim realistik i plagave dhe lëndimeve, fotografim dhe lajmërim. Përderisa dy grupet e para ishin të dedikuara për përforcimin e kapaciteteve të klubeve të të rinjëve, grupi për informim dhe fotografim përgatitej për zhvillim të komunikimit dhe informimit atraktiv për ngjarjet dhe aktivitetet tek të rinjët e Kryqit të Kuq.

# KRYQI I KUQ NË AKSION – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE

Kryqi i Kuq i RM-së nëpërmjet Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit si implementues i projektit, me sukses 10 vite e zbaton programin “Kryqi i Kuq në aksion promovimi i vlerave humane” (KKA – PVH) në bashkëpunim me Ministrinë për arsim dhe shkencë.

Në vitin e kaluar në projekt ishin të kyqur gjithësej 1.105 të rinjë, me 115 projekte të vogla rekorde të pëpunuara dhe 11.820 euro të mbledhura. Qëllimet e projekteve si dhe qëllimi i mjeteve të mbledhura janë të përcaktuara në mënyrë lokale, më shpesh për socializimin e të rinjëve të margjinaliuzar dhe personave social të përjashtuar, përkrahje për intervenime dhe ndihma shëndetësore, ngritjen e vetëdijes në rrethinë për të çuar jetë të shëndoshë etj.



## KKA – PVH kampi veror

Prej 19 – 23 gusht në qendrën “Solferino” në Strugë u mbajt kampi veror i parë ndërkombëtarë KKA- PVH i cili paraqet internacionalizimin e projektit KKA- PVH dhe finalizimin e realizimit të suksesshëm në Maqedoni. Me përkrahje të Kryqit të Kuq të RM-së, Kryqi i Kuq i R. Serbisë në vitin 2006 filloi implementimin e programit, kurse R. e Shqipërisë dhe R. e Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2007. Pjesëmarrës në kampin veror ishin të rinjët nga vendet të cilët e implementuan programin (Sërbia, B dhe H, Maqedonia dhe Shqipëria), si dhe mysafirë nga Finlanda, Danimarka, Turqia, Bullgaria, Zvicra, dhe përfaqësues nga Federata Ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe – Gjenevë. Një ndër qëllimet e kampit ishte edhe prezantimi i programeve nacionale dhe prezantimi i projekteve të përpunuara.

Si rezultat i kampit një përfaqësues i Maqedonisë ishte i ftuar që të marrë pjesë në mbledhjen e Gjenevës të Shoqatave nacionale të cilat implementojnë progame për të rinjë në këtë lëmi në krijimin e mjeteve të cilat do ti kishin paraqitur kahjet për implementim. Si rrumbullaksim i këtyre aktiviteteve dy përfaqësues morën pjesë në takimin për këmbim të përvojave dhe krijim të mjeteve për punë në temën “Promovimi i vlerave humane”, e cila u mbajt në Tubaniso Republika e Mali, Afrikë.

## Shoqërim pa kufi Deti Suto 2008

Kryqi i Kuq i Malit të Zi – Deti Suto ishte nikoqir i projektit të 11-të ndërkombëtarë të të rinjëve Shoqërim pa kufi, morën pjesë përfaqësues të 7 shoqatave nacionale. Kryqin e Kuq Maqedonas e paraqitën pesë vullnetarë të rinjë të zgjedhur sipas rezultateve të arritura në ciklin KKA – PVH për vitin 2007 – 2008. Në këtë kamp u punua në temat regullorja e të rinjëve dhe udhëheqje me të rinjë, tolerim, DNH dhe bërja e projekteve për nevojat e bashkësisë. Pas kampit të kryer pjesëmarrësit iu përkushtuan këmbimit të mëtejshëm nacional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim plotësimin e obligimeve të cilat u paraqitën në kamp. Vullnetarët e Kryqit të Kuq të RM-së pas mbarimit të kampit realizuan 4 projekte dedikuar për femijët e familjeve të rezikuara sociale.

## AKTIVITETE PROJEKTUESE

### 1. Vetëdija e të rinjëve për rezik dhe pasojat nga dhuna

Me përkrahjen e Kryqit të Kuq të Gjermanisë u mbajt projekti Vetëdija e të rinjëve për rezik dhe pasojat e dhunës, vullnetarë të rinjë të trajnuar të Kryqit të Kuq nëpërmjet simulimeve dhe punëtorive interaktive në shkollat fillore. Ky projekt u realizua me ndihmën e personave profesional nga instituti për punë sociale dhe politikë sociale, me ndihmën e të cilit plotësisht është botuar edhe doracak për punë në teren me temë dhunë moshatare. Ky projekt u realizua gjithësej në 27 OKKK dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit.

| Vetëdija e të rinjëve për rezik dhe pasoja nga dhuna | |
|---|---|
| Numri i edukatorëve moshatar të trajnuar | 80 |
| Numri i punëtorive të mbajtura | 162 |
| Numri i pjesëmarësve | 4374 |

## 2. Dashuro me kujdes! Jeto sigurtë! - edukim moshatar i të rinjëve

Me përkrahje të Kryqit të Kuq Spanjol, gjithësej në 31 OKKK dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit u realizua projekti Dashuro me kujdes! Jeto sigurtë!. Bëhet fjalë për edukim moshatar nëpërmjet organizimit me të rinjë në moshë prej 14 - 21. Për nevojat e projektit janë trajnuar 70 edukatorë moshatarë, është shypur doarcak dhe flaer me përmbajtje edukative për punë në teren.

| Dashuro me kujdes! Jeto sigurtë! | |
|---|---|
| Numri i edukatorëve moshatarë të trajnuar | 70 |
| Numri i punëtorive të mbajtura | 118 |
| Numri i pjesëmarrësve | 2897 |
| Përqindja e diturive para mbajtjes së punëtorive | 51 % |
| Përqindja e diturive pas mbajtjes së punëtorive | 61,5 % |

## PËR FËMIJËRI MË TË LUMTUR

Me qëllim për ngritjen e vetëdijes te të rinjët për ndihmën e nevojshme, solidaritet dhe humanitet mes të rinjëve të cilët ballafaqohen me vështirësi sociale mes të rinjëve të cilët ballafaqohen me vështirësi sociale nëpërmjet të organizimit të garave sportive, në vitin 2008 u organizua aksion tanimë tradicional sportivo - rekreativ dhe humanitar “Për fëmijëri më të lumtur” në aksionin morën pjesë 20 OKKK dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit. Vlera e boneve pjesëmarrëse ishte 30 denarë, kuse mjetet e mbledhura prej 18.141 bona të shitura, ishin dedikuar për grupe të caktuara qëllimore në OKKK me prioritet të përkrahjes sociale të grupeve të margjinalizuara, fëmijëve të familjeve të rrezikuara sociale dhe fëmijë me nevoja të posaçme.





## NGJARJET PROMOVUESE

Me rastin e kalendarit tradicional të aktiviteteve dhe masnifestime, në nivel nacional janë organizuar dy ngjarje më të mëdha promovuese.

Me rastin e Javës së Kryqit të Kuq në bashkëpunim me Institutin maqedonas për mediume dhe Drejtorinë për kulturë dhe art, më 11 maj në parkun e qytetit në Shkup, është organizuar ngjarje e madhe muzikore e vizituar nga disa mijë vizitorë, ku janë promovuar aktivitetet e Kryqit të Kuq.

Më 5 dhjetor me rastin e Ditës botërore të vullnetarizimit, si dhe miratimi i Strategjisë për vullnetarizim 2008 - 2012 të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë vullnetarët e rinjë organizuan aheng të madh me ndërmjetësim të mediumeve, për tërheqjen e vullnetarëve të rinjë dhe promovimin e aktiviteteve vijuese.
.



> **“Marrëdhëniet me publikun janë sikur vozitje në mjegull - patjetër duhet ti keni dritat e kyçura, jo për të shikuar se ku shkoni, por që tju shohin të tjerët juve”.**
>
> **Julia Zuelka**
> **Vinona Univerzitet Shtetëror**

Zhvillimi intenziv në tërë botën, e të ashtuquajturës “Shoqëri informative”, është fakt i jetës së përditëshme. I ballafaquar me këtë sfidë, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë tanimë një kohë të gjatë prapa mundohet të adaptohet në teknologjitë e reja informative dhe komunikative dhe të përgatitet për interaksion më të madh dhe më të shpejtë me grupet qëllimore dhe me qytetarët në përgjithësi. Në vitin e kaluar aktivitetet ishin të drejtuara në nevojën e organizatës për intenzivimin e aktiviteteve komunikative, me qëllim që të rritet kredibiliteti i tij dhe të ngritet vetëdija për rolin e tij mes subjekteve kyçe të interesuara. Organizata u mundua që ta zbatojë bazën sipas së cilës do të mund ta përcjellë përparimin në kuptim që të adaptojë vetëvehten, me qëllim që të përgjigjet në kërkesat e kategorive të përdoruesve të mjeruar.




## UEB FAQJA E KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Funksionimi i UEB faqes së Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në vitin e kaluar përfshihet me mënyrën e përcjelljes së rrjedhave bashkëkohore në teknologjinë informatike. Të gjithë përdoruesit e internetit në adresën www.redcross.org.mk patën mundësinë që të njoftohen me organizatën, misionin e tij dhe aktivitetet që i realizon gjatë tërë vitit. Analiza vjetore e rezultateve për vizitën e ueb faqes, tregon përparim në pjesën e lidhjes direkte elektronike me të gjithë të interesuarit për punën e Kryqit të Kuq të RM-së, si dhe për përgatitshmërinë e tyre që të kyqen në realizimin e misionit human të shoqatës nacionale.

## Gazeta elektornike “INFO +“

Botimi javor i gazetës elektronike të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë “**INFO +**”, paraqiti një ndër mjetet për modernizimin e komunikimit me grupe të ndryshme qëllimore, kurse njëkohësisht edhe mënyrë për klasifikimin e rregullt të informacioneve për aktivitetet e realizuara në publik. Koncepti i bartjeve të tyre nëpërmjet rrugës elektronike deri te lexuesit, nga Qendra e KKRM-së, në bashkëpunim me organizatat komunale dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit, sipas analizave të bëra, ndihmoi pjesërisht në zbatimin e komunikimit të brendshëm, por edhe deri në rritjen e transparencës para publikut.

Analizat treguan se nga numri i parë të gazetës elektronike në mars të vitit 2006, e deri në fund të vitit 2008, në fillim botimet distribuoheshin në 35.000 e-mail adresa, që ta përfundojmë vitin 2008 me 59.000 lexues të gazetës elektronike. Sa i përket komunikacionit të brendshëm dhe mënyrës për përgatitje, tre vitet e ekzistimit treguan kyçje aktive me tekste nga aktivitetet e realizuara në 11



organizata komunale, Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit dhe Qendra e shoqatës nacionale. Përqindja e realizimit e tregon që vijon:




Në analizën e përgatitur ku flitet për rreth 650 tekste të shpallura deri më tani në gazetën elektronike, mund të ndahen përmbajtjet të cilat tregojnë aktivitete në pjesën e KKA – PVH, aktivitete të planit shëndetësor preventiv, si dhe aktivitete nga programi ZhPB (Zhvillim i përbashkët i bashkësisë).

Përfundimi pas rezultateve të marrura nga analiza e punës së deritanishme tregojnë rezultate pozitive në pjesën e metodës për komunikim me publikun, por njëkohësisht kahëzojnë edhe në mendime për tejkalimin e dobësive në komunikimin e brendshëm në Kryqin e Kuq të RM-së.

## VEPRIMTARI BOTUESE

Botimet e shtypura të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në masë të madhe kontribuan për imazhin e organizatës, dhe rritjen e transparencës, dhe njëkohësisht paraqitën edhe mënyrë efikase të komunikimit të drejtëpërdrejtë me publikun. Edhe në vitin e kaluar me material të shtypur propagandues u shënuan aktivitetet tradicionale dhe aktivitete tjera në organizatë, dhe ishin të shpallura dy botime të gazetës “Meridiane humane”. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë edhe më tej vazhdoi në bashkëpunim me Postat Maqedonase që ti shtypë triskat postale me përmbajtje lidhur me katër aktivitetet tradicionale të Kryqit të Kuq të RM-së.



## BASHKËPUNIM ME MEDIUMET

Komunikimet me mediumet gjithashtu paraqesin një ndër prioritetet në vitin e kaluar nëpërmjet lajmërimeve për shtypin, konferencat për shtyp dhe paraqitjet publike në mediumet elektronike. Edhe këtë vit bashkëpunimi me ata u tregua si mjet jashtëzakonisht i dobishëm për lidhjen tonë direkte me publikun. Vazhdimi në bashkëpunimin edhe këtë vit u vazhdua me mbajtjen e seminarit tradicional me gazetarë ku morën pjesë 13 përfaqësues të redaksioneve të mediumeve për shtyp dhe elektronik. Edhe këtë vit seminari ishte i organizuar me zyrën e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.




# MATERIALE TË SHPALLURA

Një ndër angazhimet themelore të Kryqit të Kuq të RM-së arritjet e veta i plason me transparencë dhe haptazi para publikut. Për atë qëllim gjatë vitit të kaluar janë shpallur dokumente dhe materiale me përmbajtje informativo- edukuese.

## STRATEGJI DHE PUBLIKIME

- Strategji për zhvillim të Kryqit të Kuq të RM-së në planin për përgatitshmëri dhe veprimtari.
- Strategji për diseminim
- Strategji për punë në Shërbimin për kërkim
- Strategji për mobilizimin e fondeve
- Strategji për vullnetarizim

- Programi për punë në Kryqin e Kuq të RM-së për vitin 2008
- Raport për punën e Kryqit të Kuq të RM-së për vitin 2007
- Raport për punën e Kryqit të Kuq të RM-së për periudhën mandatare 2004 - 2008
- Gazeta "Humani Meridiani"

## POSTERË

## FLAERË




## DORACAKË

- Ndihmë të parë në rrugë
- Ndihmë të parë në vendin e punës
- Doracak për edukim moshatar “Dhunë moshatare”
- Doracak për edukim moshatar për preventivë nga HIV/SIDA dhe sëmundje seksuale bartëse
- Doracak për shërbim vullnetar
- Rregullore për vullnetarizim

## BROSHURA

- Gjidhënie e suksesshme dhe të ushqyerit në kohe
- Zvogëlimi i pasojave dëmtuese nga përdorimi i drogave
- Çka është tuberkuloza?
- Bën nje gjest human, vullnetarisht dhuro gjak!
- Dita e Juaj 17 mars

## TRISKA POSTALE

- Java për luftë kundër kancerit
- Java për luftë kundër tuberkulozës
- Java për luftë kundër HIV/SIDA
- Java e Kryqit të Kuq të RM-së

**Kryqi i Kuq i RM-së vazhdimisht punoi në mbindërtimin e kapaciteteve të veta në të gjitha lëmitë programore falenderuar përkrahjes ndërkombëtare nga komponentet e Lëvizjes të cilat me përkrahje finansiare dhe profesionale vazhdimisht dhanë kontribut për implementimin e qëllimeve zhvillimore të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.**

## BASHKËPUNIM BILATERAL

### DHE PËRKRAHJE NDËRKOMBËTARE NË PROJEKTE DHE PROGRAME

Gjatë vitit 2008 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë realizoi bashkëpunim të frytshëm me më shumë shoqata nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe. U realizuan disa vizita punuese të shoqatave nacionale në rajon dhe gjithashtu përfaqësues të më shume shoqatave nacionale morën pjesë në trajnimet dhe takimet punuese të cilat i organizoi shoqata e jonë nacionale me qëllim që të këmbehen përvojat dhe dituritë pozitive për promovimin e aktiviteteve të Lëvizjes.

Përkrahja programore ishte e siguruar nëpërmjet Fondit për mbindërtim intenziv të kapaciteteve të Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe në pjesën e mbindërtimit të sistemit informativ menaxhment, mobilizim të fondeve dhe menaxhment të vullnetarëve dhe të punësuar në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë. Projekti do të implementohet në kohëzgjatje prej tre vitesh. Federata ndërkombëtare e përkrahu edhe projektin për zhvillim të përbashkët të bashkësive që ishte implementuar në tre organizata komunale të shoqatës sonë nacionale dhe siguroi përkrahje në pjesën e përgatitshmërisë dhe veprimtari gjatë katastrofave (trajnim të ekipeve rajonale për veprim gjatë katastrofave), Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq – Zyrja Shkup siguroi përkrahje të pjesërishme programuese në pjesën e diseminimit, përgatitshmëri dhe veprimtari gjatë katastrofave, shërbimi për kërkim dhe zhvillim organizativ që ishin të realizuara me sukses në vitin 2008. Vitin e shënoi edhe bashkëpunimi i suksesshëm me Komesariatin e Lartë për ikacakë në lëminë e sigurimit të përkrahjes për mbrojtje shëndetësore të kërkuesve të azilit në Republikën e Maqedonisë si dhe Marrëveshja e nënshkruar për bashkëpunim me UNDP për programin për përgatitshmëri dhe veprimtari gjatë katastrofave që do të implementohet deri në shtator të vitit 2009.

## NGJARJE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit përfaqësues të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë morën pjesë në më shumë konferenca ndërkombëtare, seminare, mbledhje, trajnime dhe kampe të të rinjëve. Aktivitetet ndërkombëtare për veprimtari janë pjesë integruese të këtij raporti.

## KONFERENCA E 16-të BALLKANIKE




Konferenca e 16-të Ballkanike e shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe nga rajoni Ballkanik u mbajt më 25 deri 27 qershor të vitit 2008 në Sofje, Bullgari. Në Konferencën Ballkanike morën pjesë shoqatat nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Turqia, Kroacia, Sllovenia, Katari dhe Italia si dhe përfaqësues nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Pjesëmarrësit në Konferencë debatuan dhe këmbyen përvoja nga puna e tyre në shoqatat nacionale në temat që vijojnë: kapaciteti dhe përvojat e shoqatave Ballkanike nacionale gjatë katastrofave në rajon; sfida të reja dhe leksione të mësuara; aksion të përbashkët dhe bashkëpunim të mundshëm për preventimin e pasojave humanitare nga ndryshimet klimatike; menaxhment të vullnetarëve; mobilizimin e resurseve; shërbime shëndetësore dhe sociale për kategori të ndryshme të popullatës së mjeruar; diseminim të DNH dhe parimet e Lëvizjes; migrime, integrim të ikacakëve, migrantë dhe kërkues të azilit, preventim të tregtisë me njerëz dhe zbatim i lidhjeve familjare.

Delegacioni i Kryqit të Kuq të Maqedonisë doli me dy prezantime duke e prezantuar punën e tij në pjesën e përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave dhe mobilizimit të resurseve. Dokumenti final i Konferencës i përmban angazhimet për përparimin e mëtejmë të bashkëpunimit mes shoqatave nacionale të ballkanit në të gjitha lëmitë programore si dhe promovim të këmbimit të rregullt të përvojave dhe persona profesional nga rajoni i cili mund të jep kontribut për implementimin  e shërbimeve më kualitative dhe të llojllojshme të cilat janë me interes për kategoritë e mjeruara të popullatës që i shërben Lëvizja jonë. Konferenca ballkanike ishte e përdorur për realizimin e takimeve bilaterale me përfaqësuesit e shoqatave nacionale dhe Federatës Ndërkombëtare dhe KNKK të cilët morën pjesë në Konferencë.

## MBLEDHJA E LIDERËVE

### E FEDERATËS NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSËMHËNËS SË KUQE

Në periudhën prej 7 – 8 gusht të vitit 2008, në Shkup, Republikën e Maqedonisë u mbajt Mbledhja e liderëve për shoqatat nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe nga Kaukazi jugor. Mbledhja ishte organizuar nga ana e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe dhe Kryqit të Kuq të Repubikës së Maqedonisë kurse në atë mbledhje përskaj organizatorëve morën pjesë sekretarë gjeneral dhe kryqtarë nga Kryqi i Kuq i Ermenisë, Kryqi i Kuq i Gruzisë, Gjysëmhëna e Kuqe e Azerbejxhanit, Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq dhe përfaqësues të shoqatave donatore nacionale të Kryqit të Kuq Britanik, Kryqit të Kuq të Norvegjisë, Kryqit të Kuq të Danimarkës dhe Kryqit të Kuq të Finlandës. Delegacioni i Federatës Ndërkombëtare ishte i përbërë nga përfaqësues të Zonës Europiane dhe Zyrës Rajonale për Europë Qëndrore nga Budapesta.

Qëllimi primar në mbledhje ishte prezentimi i më shumë përmbajtjeve për shoqatat nacionale nga Kaukazi jugor. Gjatë punës dyditore ishte prezantuar Modeli i Ri Operativ i Qëllimeve të Agjendës Globale të Federatës Ndërkombëtare, Strategjia për përkrahje e Federatës Ndërkombëtare për vendet e Kaukazit jugor, strategji dhe plane të shoqatave donatore nacionale për përkrahje të shoqatave nacionale nga Kaukazi jugor dhe prezantim i programit për përkrahje të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Prapëseprapë, fokusi kryesor i mbledhjes së liderëve ishte prezantimi i përmbajtjeve programore dhe përvojave të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë posaçërisht në pjesën e mobilizimit të resurseve.



## QASJE NË FONDET E UE-së

Mbledhje e koordinuesve të shoqatave nacionale të Kryqit të Kuq të Unionit Europian. Në periudhën prej 16 – 17 shtator të vitit 2008, në Budapestë – Hungari, përfaqësues i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë mori pjesë në mbledhjen e koordinatorëve të shoqatave nacionale të Kryqit të Kuq nga vendet anëtare të unionit Europian.

Organizues i mbledhjes ishte UE zyrja e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe me seli në Bruksel. Qëllim primar ishte formimi i rrejtit Europian të koordinatorëve përgjegjës për përgatitjen dhe implementimin e projekteve me mjete të Unionit Europian. Gjatë punës dyditore pjesëmarrësit e grupit punues ishin të njoftuar me procedurat dhe kriteret të cilat duhet të plotësohen për aplikim në projekte të Unionit Europian, për nevojën e këmbimit të informacioneve mes shoqatave nacionale posaçërisht në pjesën e bartjes së përvojave pozitive dhe mundësitë të cilat dalin me implementimin e projekteve të cilat janë në interes të kategorive të mjeruara të popullatës. Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë ka status të vendit kandidat për anëtarësim në Unionin Europian mundësitë për aplikim në projektet e Unionit Europian janë të kufizuara. Kryqi i Kuq i Maqedonisë me prezantimin e tij i prezantoi projektet rrjedhëse dhe arritjet si dhe sferat e interesit për bashkëpunim me periudhën që vijon.

Përkrahje bilaterale nga Kryqi i Kuq Spanjol për sigurim të trajnimit dhe përkrahje për qasje në Fondet e UE-së. Në periudhën prej 18 – 20 nëntor të vitit 2008 z.Alejandro Rojas Marcos De La Viesca dhe Sandra Calderon nga Kryqi i Kuq Spanjol e vizituan shoqatën tonë nacionale dhe realizuan takime me përfaqësues të Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe zyrën e Unionit Europian në RM me qëllim që të sigurojnë përkrahje për Kryqin e Kuq të Maqedonisë në procesin e aplikimit dhe përdorimin e fondeve të Unionit Europian. Përkrahja e këtij plani do të vazhdojë në vitin 2009 gjatë sigurimit të resurseve kadrovike të cilët do të zbatojnë trajnim të kuadrove të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për përcjellje të rregullt të procedurave dhe aplikimeve në projekte të cilat finansohen nga Unioni Europian.

**“Gjendja e mirë e njeriut varet në masë të madhe nga mundësia e tij që të jetë në kontakt me të afërmit e tij apo të marrë informacione për atë se çka ju ka ndodhur”.**

# Realizimi i planifikimit

- Shërbimi për kërkim i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, përgatiti prezentim të strategjisë për punën e shërbimit 2008 – 2010, për Sekretarët e organizatave Komunale të Kryqit të Kuq ku ishte e theksuar nevoja për përforcim të kapaciteteve operative me qëllim që të sigurojë shërbime të qëndrueshme për zbatimin e lidhjeve familjare në nivel nacional dhe komunal;

- Ishte përgatitur program standard për trajnim të vullnetarëve dhe të punësuarve në organizatat komunale të Kryqit të Kuq, në bazë të nevojave për trajnim të këtillë “Trajnim themelor” për punë në Shërbimin për kërkim dhe “Trajnim për punë në Shërbimin në rast të katastrofave”, ishin mjetet themelore gjatë realizimit të trajnimeve të cilat ishin organizuar gjatë vitit;

- Ishin definuar modelet dhe procedurat për punë në Shërbimin për kërkim në situata të katastrofave natyrore. Për atë qëllim u mbajt punëtori njëditore për personat profesional të punësuar në Shërbimet për kërkim të organizatave komunale të Kryqit të Kuq, me temë “Shërbimi për kërkim në rast të katastrofave”;

- Kryqi i Kuq i RM-së ka siguruar pozitë përkatëse për shërbimin për kërkim në strukturën e organizatës. Nëpërmjet qasjes së adaptuar organizative, me trajnime të inicuara nga pjesa e organizatave komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit u fillua me krijimin e mekanizmave për rekrutim dhe motivim të vullnetarëve, të cilët në situata të caktuara do të përgjigjeshin në nevojat e shërbimit;

- Me rekomandim të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq ishin të ndërmarura aktivitetet për revidimin e kritereve të Shërbimit për kërkim për kyqje në kategorive të reja të shfrytëzuesëve në pajtueshmëri me nevojat të cilat do të dalin;

- Rregullisht u përgatitën statistika mujore për punën e Shërbimit për kërkim. Sipas statistikës së bërë shërbimi në data - bazë për vitin 2008 ka regjistruar 7 raste të reja, prej së cilave 3 llogariten si të mbyllura, përderisa për 4 prej tyre ende bëhet procedura për gjendjen e personave të cilët kërkohen;

## RISI NË PUNË

Sipas Programit për punë të Shërbimit për kërkim të Kryqit të Kuq të RM-së për vitin 2008, ishte e paraparë punëtori njëditore me temë: "Shërbimi për kërkim në rast të katastrofave" për të punësuarit në Shërbimin për kërkim, e cila në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq u mbajt më 21.10.2008

"Kjo problematikë deri tani është e përpunuar me të punësuarit profesional në Shërbimin për kërkim nga organizatat komunale, dhe për atë shkak përshtypje të përgjithshme është se e njejta është interesante dhe shumë e dobishme për personat të cilët punojnë në zhvillimin e këtij shërbimi në Kryqin e Kuq të RM-së. Pajtohem me propozimet të cilat dolën nga të pranishmit për aktivitetet e mëtejshme të këtij plani. Sigurisht se do të jenë të dobishme punëtori të këtilla dhe të ngjajshme për kryetarët e komisioneve për përgatitshmëri dhe veprimtari në rast të katastrofave dhe për anëtarët e komisioneve të Shërbimit për kërkim në organizatat komunale, por edhe organizim të trajnimeve themelore për vullnetarë dhe të punësuar profesional në komunat ku deri tani nuk ka pasur trajnim të këtij lloji." – Biljana Ristovska, përshtypjen e ndau me kolegët e vet, personi profesional i punësuar në Shërbimin për kërkim të Kryqit të Kuq në Manastir.



Mbindërtim intenziv i kapaciteteve – sistem informativ menaxhment, mobilizim të fondeve dhe menaxhment me vullnetarë dhe të punësuar

Kryqi i Kuq në aksion –
Promovim i vlerave humane – KKA – PVH

Zvogëlimi i dëmeve nga përdorimi i drogës

Plane lokale aksionare për kontrollin e tuberkulozit

Mobilizimi i popullatës rome për zbulim aktiv të rasteve me tuberkulozë

Lidhje rrejtore në lëminë e ndihmës së parë

Klube për promovimin e gjidhënies optimale dhe ushqim të foshnjeve dhe fëmijëve të vegjël

“Lidhje rrjetore nga lëmia e dhurimit të gjakut – përmirësim i dhurimit vullnetar të gjakut te popullata e re”

“Motivimi i popullatës së re për dhënie vullnetare të gjakut”

Zhvillim i përbashkët i bashkësive – ZhPB

Vetëdija e të rinjëve për rrezik dhe pasoja nga dhuna

“Dashuro me kujdes, jeto sigurtë!” edukim moshatar për preventivë nga HIV/SIDA dhe ISB



# PROJEKTE TË REALIZUARA



# RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2008

Transparenca dhe raporti i punës financiaro-materijale paraqet parakusht të rëndësishëm për funkcionimin e suksesshëm të organizatës.

Me qëllim që të tregohet puna gjithpërfshirëse e Kryqit të Kuq të Maqedonisë, në Raportin financiar janë përmbajtur të hyrat dhe të dalurat e pklanifikuara dhe të realizuara të organizatës në vitin 2008.

Raporti vjetor është vërtetim për implementimin e suksesshëm të aktiviteteve programore dhe projektuese të përkrahura nga partnerë të vendit dhe të jashtëm të organizatës, si dhe nga Fondi për zhvillim të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, që paraqet mjet për përkrahje programore dhe projektuese të organizatave komunale të Kryqit të Kuq. Në vitin e kaluar obligimi i organizatave komunale të Kryqit të Kuq për participim në Fondin për zhvillim është realizuar tërësisht, me çka mundësohet fillimi i një cikli të ri për përkrahje të projekteve për vitin e ardhshëm.

Nga ana e Këshillit ekzekutiv të Kryqit të Kuq të RM-së u formua Komision, i cili zbatoi revizion të brendshëm në punën finaciare dhe materijale.Gjithashtu ishte angazhuar shtëpia e jashtme e pavarur për revizion, e cila zbatoi revizion në pajtueshmëri me Ligjin për revizion dhe Standardet ndërkombëtare për raport financiar dhe dispozita kontabiliste të cilat vlejnë në Republikën e Maqedonisë. Sipas mendimit të shtëpisë për revizion, gjendja financiare e organizatës Kryqi i kuq i RM-së është treguar real dhe objektiv. Puna e treguar e organizatës nëpërmjet të dhënave financiare tregon një vit të kryer me sukses me zbatimin e Buxhetit prej 97,98%. Shkaku për mosrealizim të Buxhetit të planifikuar, është zvogëlimi i të ardhurave në bazë të ndihmës së parë në shoqatën nacionale. Të hyrat personale në përgjithësi të realizuara, janë të përfaqësuara me 28,9 %, kurse të hyrat nga organe dhe donatorë me 71,1 %.

Në pjesën e të dalurave mund të vërtetohet se shpenzimi është i kontrolluar dhe me qëllim, që është qëllim themelor i çdo organizate. Nga të dalurat e përgjithshme të realizuara, 57.07 % kanë të bëjnë me shpenzimet funkcionale gjegjësisht ato programore, të dalurat për rrogën e të të punësuarve është 11,85 %, kurse shpenzimet materijale janë 31,07 %.

## TË HYRA NË VITIN 2008




## TË DALURA NË VITIN 2008









Nga të dhënat për lëvizjen e të dalurave mund të konstatohet se realizimi i të dalurave për investime kapitale në zyrën qendrore dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq ësht i përfaqësuar me rëndësi në të dalurat e përgjithshme dhe është 15,64%, përqindje e së cilit është realizuar sikur të ishin personale, ashtu dhe mjete të donatorëve, gjegjësisht nga të dalurat e përgjithshme kapitale në qendrën 12,98% apo 1.062.130,00 denarë, kanë të bëjnë me të dalurat kapitale për organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit.

Një pjesë nga teprica e mjetev financiare gjegjësisht dallimi pozitiv mes të hyrave dhe të dalurave ka të bëjë me projekte realizimi i së cilave vazhdon në vitin 2009.

Raporti financiar ka të bëjë vetëm me punën e zyrës së qendrës të Kryqit të Kuq. Organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit kanë buxhete personale të cilat përbëhen nga më shum burime për të hyra (të definuara me Ligj, bashkëpunim partneror, dhënie të shërbimeve, qira etj), një pjesë e të hyrave të realizuara nëpërmjet transfereve nga qendra dhe kanë të bëjnë me realizimin e programeve nacionale (dhurimi i gjakut) dhe mjete të siguruara nga donatorë.

## TË DALURA KAPITALE NË VITIN 2008




## TË DALURA KAPITALE PËR OKKK NË VITIN 2008




## TË HYRAT E PËRGJITHSHME NË VITIN 2008



# RAPORTI FINANCIAR
## Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë

| | Buxheti 2008 | Të realizuara 2008 | % | % Në 2007 |
|---|---|---|---|---|
| **TË HYRA TË PËRGJITHSHME** | **57.554.834,00** | **56.391.343,00** | **97,98** | **108,56** |
| Burime personale të të hyrave | 12.420.399,00 | 16.298.127,50 | 131,22 | 140,43 |
| Të hyra nga organet/donatorë | 45.134.435,00 | 40.093.215,50 | 88,83 | 101,36 |
| **TË DALA TË PËRGJITHSHME** | **57.554.834,00** | **52.287.976,00** | **90,85** | **102,61** |
| Rroga dhe kompenzime të të punësuarve | 9.816.000,00 | 6.194.464,00 | 63,11 | 78,600 |
| Të dala për materijale dhe shërbime | 7.733.000,00 | 16.248.508,50 | 210,12 | 151,29 |
| Të dala funkcionale (programore) | 40.005.834,00 | 29.845.003,50 | 74,60 | 98,920 |
| **Dallimi** | **0,00** | **4.103.367,00** | | |

## TË HYRA

| PËRSHKRIM | Burime personale | Të hyra nga org. dhe don | Buxheti 2008 | Të realizuara nga burime pers. | Të realizuara nga org. dhe don. | Të realizuara 2008 | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **74 Transfere dhe donacione** | | | | | | | |
| 741 Ministria e financave (nga Buxheti i RM-së mjete për aktivitete programore) | | 6.321.000,00 | 6.321.000,00 | | 6.324.000,00 | 6.324.000,00 | 100,05 |
| 741 Dhurimi i gjakut (Ministria e shëndetësisë) | | 9.200.000,00 | 9.200.000,00 | | 9.697.163,50 | 9.697.163,50 | 105,40 |
| 742 Veprimtari socialo-humanitare | 350.000,00 | 1.537.500,00 | 1.887.500,00 | 239.159,00 | 1.202.017,50 | 1.441.176,50 | 76,35 |
| 742 Organizim dhe zhvillim | | | 0,00 | | 4.287.982,50 | 4.527.141,50 | 100,00 |
| 742 Ndihma e parë | 6.000.000,00 | | 6.000.000,00 | 3.516.364,50 | 1.775.640,50 | 5.292.005,00 | 88,20 |
| 742 Edukim shëndetësor | | 3.328.915,00 | 3.328.915,00 | | 5.562.304,50 | 5.562.304,50 | 167,09 |
| 742 Rinia | | 498.150,00 | 498.150,00 | 147.244,00 | 2.225.168,00 | 2.372.412,00 | 100,00 |
| 742 Katastrofa | | 1.461.104,00 | 1.461.104,00 | | 2.021.793,50 | 2.021.793,50 | 138,37 |
| 742 Diseminim | | 704.000,00 | 704.000,00 | | 365.045,50 | 365.045,50 | 51,85 |
| 742 KK në akcion – PVH | | 811.800,00 | 811.800,00 | | | 0,00 | 0,00 |
| 742 Informim dhe komunikim | 100.000,00 | 701.966,00 | 801.966,00 | | | 0,00 | 0,00 |
| 742 Shërbimi për kërkim | | 130.000,00 | 130.000,00 | | 180.081,50 | 180.081,50 | 138,52 |
| 742 Njësia ndërkombëtare | | 3.800.000,00 | 3.800.000,00 | | | 0,00 | 0,00 |
| 742 Aktivitete për sigurimin e mjeteve financiare | 300.000,00 | 200.000,00 | 500.000,00 | | 318.042,00 | 318.042,00 | |
| 742 Financa | | | 0,00 | | 200.974,50 | 200.974,50 | 100,00 |
| **72 TË HYRA PA TATIM** | | | | | | | |
| 725 Nga OKK (në bazë të kotizimit) | | 2.190.000,00 | 2.190.000,00 | 1.656.710,00 | 90.000,00 | 1.746.710,00 | 79,76 |
| 725 Donacion nga persona fizik /tel. Të punësuar | 280.000,00 | | 280.000,00 | 180.033,00 | | 180.033,00 | 64,30 |
| 725 Donacion nga persona fizik/shitja e veturave | 600.000,00 | | 600.000,00 | 310.575,00 | | 310.575,00 | 51,76 |
| 725 Triska me shtesë (nga Ligji i KK) | 450.000,00 | | 450.000,00 | 268.743,00 | | 268.743,00 | 59,72 |
| 723 Nga qiraja e objektit afarist/të hyra tjera | 1.650.000,00 | | 1.650.000,00 | 1.691.531,00 | | 1.691.531,00 | 102,52 |
| 725 Nga regjistrimi i veturave | 750.000,00 | 14.250.000,00 | 15.000.000,00 | | 5.843.002,00 | 5.843.002,00 | 100,00 |
| 725 Nga Qendra edukative trajnuese | 1.940.399,00 | | 1.940.399,00 | 1.056.500,00 | | 1.056.500,00 | 100,00 |
| 725 Tepricë e bartur nga viti i kaluar | | | | 7.231.268,00 | | | |
| **Të hyra të përgjithshme** | **12.420.399,00** | **45.134.435,00** | **57.554.834,00** | **16.298.127,50** | **40.093.215,50** | **56.391.343,00** | **97,98** |

## TË DALURA

| PËRSHKRIM | | Burime personale | Të hyra nga org. dhe don | Buxheti 2008 | Të realizuara nga burime pers. | Të realizuara nga org. dhe don. | Të realizuara 2008 | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Të dalura vijuese** | | | | | | | | |
| **401** | **Rroga dhe kompenzimet** | | | | | | | |
| 4011 | Rroga neto | 4.700.000,00 | | 4.700.000,00 | 3.046.013,00 | | 3.046.013,00 | 64,80 |
| 4012 | Kompenzim për rrugë tët të punësuarve | 320.000,00 | | 320.000,00 | 147.306,00 | | 147.306,00 | 46,03 |
| 4012 | Kompenzim për ushqim të të punësuarve | 650.000,00 | | 650.000,00 | 665.188,00 | | 665.188,00 | 102,33 |
| 4012 | Kompezim për pushim vjetor | 200.000,00 | | 200.000,00 | | | 0,00 | 0,00 |
| 4012 | Kompenzime tjera | 100.000,00 | | 100.000,00 | 98.000,00 | | 98.000,00 | 98,00 |
| **402** | **Kontribute nga rroga dhe tatimi personal** | | | | | | | |
| 4021 | Kontribute nga rroga e të punësuarve | 3.196.000,00 | | 3.196.000,00 | 1.611.939,00 | | 1.611.939,00 | 50,43 |
| 4025 | Tatimi personal nga rroga | 350.000,00 | | 350.000,00 | 268.607,00 | | 268.607,00 | 76,74 |
| 4025 | Tatim personal nga kompenzimet (mëditje, shpërblime jubilare) | 300.000,00 | | 300.000,00 | 296.757,00 | 60.654,00 | 357.411,00 | 119,13 |
| **Të dalura të përgjithshme për rrogë** | | **9.816.000,00** | | **9.816.000,00** | **6.133.810,00** | **60.654,00** | **6.194.464,00** | **63,106** |
| **420** | **Të dalura rrugore dhe ditore** | | | | | | | |
| 4201 | Udhëtim jasht vendit | 300.000,00 | 400.000,00 | 700.000,00 | 1.080.291,50 | 50.642,00 | 1.130.933,50 | 161,56 |
| 4201 | Udhëtim në vend | | | | 64.752,00 | 334.764,00 | 399.516,00 | 100,00 |
| **421** | **Shërbime komunale** | | | | | | | |
| 4211 | Rryma elektrike | 500.000,00 | | 500.000,00 | 402.505,50 | | 402.505,50 | 80,50 |
| 4211 | Ujësjellës dhe kanalizim | 40.000,00 | | 40.000,00 | 50.251,50 | | 50.251,50 | 125,62 |
| 4211 | Mbeturina | 40.000,00 | | 40.000,00 | 28.571,00 | | 28.571,00 | 71,42 |
| **422** | **Nxemje** | | | | | | | |
| 4221 | Nxemje qendrore | 350.000,00 | | 350.000,00 | 381.470,00 | | 381.470,00 | 108,99 |
| **423** | **Komukacion dhe transport** | | | | | | | |
| 4231 | Postë | 60.000,00 | | 60.000,00 | 127.992,50 | 3.818,50 | 131.811,00 | 219,68 |
| 4231 | Telefon dhe faks | 300.000,00 | 150.000,00 | 450.000,00 | 612.092,00 | 64.764,00 | 676.856,00 | 150,41 |
| 4231 | Internet | 100.000,00 | | 100.000,00 | 74.243,00 | | 74.243,00 | 74,24 |
| 4232 | Karburante | 350.000,00 | 200.000,00 | 550.000,00 | 817.242,50 | 331.733,00 | 1.148.975,50 | 208,90 |
| 4232 | Shpenzime për regjitrim të veturave | 200.000,00 | | 200.000,00 | 127.027,00 | | 127.027,00 | 63,51 |
| 4232 | Të dalura tjera për transport (pagesë për rrugë, larja e veturave, ngjitja e gomave) | 50.000,00 | | 50.000,00 | 36.756,00 | | 36.756,00 | 73,51 |
| **423** | **Materiale** | | | | | | | |
| 4231 | Material për zyre | 200.000,00 | 361.596,00 | 561.596,00 | 435.569,50 | 310.818,00 | 746.387,50 | 132,90 |
| 4231 | Parapagim për revista dhe literaturë profesionale | 40.000,00 | | 40.000,00 | 37.404,50 | | 37.404,50 | 93,51 |

| | PËRSHKRIM | Burime personale | Të hyra nga org. dhe don | Buxheti 2008 | Të realizuara nga burime pers. | Të realizuara nga org. dhe don. | Të realizuara 2008 | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4231 | Traka, kaseta etj për AOP | 50.000,00 | 200.000,00 | 250.000,00 | 72.442,00 | | 72.442,00 | 28,97 |
| 4259 | Kopjim, shtypje dhe botim i materialeve | 1.253.000,00 | 3.375.019,00 | 4.628.019,00 | 1.259.494,00 | 3.081.989,00 | 4.341.483,00 | 93,80 |
| | Organizim dhe zhvillim | 100.000,00 | 100.000,00 | 211.246,00 | 187.410,00 | | 398.656,00 | 100,00 |
| | Informim dhe komunikim | | 601.966,00 | 601.966,00 | 63.105,00 | | 63.105,00 | 10,48 |
| | Diseminim | 123.000,00 | 123.000,00 | 246.000,00 | 26.078,00 | 95.384,00 | 121.462,00 | 49,37 |
| | Veprimtari shëndetësore – edukuese | | 265.553,00 | 265.553,00 | 50.804,00 | 268.952,00 | 319.756,00 | 100,00 |
| | Ndihma e parë | 800.000,00 | | 800.000,00 | 617.422,00 | | 617.422,00 | 77,17 |
| | Bashkëpunim ndërkombëtar | | 300.000,00 | 300.000,00 | | | | |
| | Dhurim i gjakut | | 1.900.000,00 | 1.900.000,00 | | 2.310.583,00 | 2.310.583,00 | 121,61 |
| | Veprimtari socialo – humanitare | | 184.500,00 | 184.500,00 | 217.351,50 | | 217.351,50 | 117,80 |
| | Shërbimi për kërkim | 30.000,00 | | 30.000,00 | | | | |
| | Marketing | | | | | 114.078,00 | 114.078,00 | 0,00 |
| | Finansa | | | | | | | |
| | Katastrofa | 100.000,00 | | 100.000,00 | 41.923,50 | | 41.923,50 | 41,92 |
| | Kampi për të rinjë | 100.000,00 | | 100.000,00 | 31.564,00 | 105.582,00 | 137.146,00 | 137,14 |
| 4234 | Pije, prodhime ushqimore, mjete për higjienë | 100.000,00 | 50.000,00 | 150.000,00 | 508.309,00 | 168.099,50 | 676.408,50 | 450,93 |
| 4239 | Materiale për mbrojtje kundër zjarrit | 20.000,00 | | 20.000,00 | | | | |
| 4239 | Materiale për qëllime të posaçme (dhurues të gjakut) | | 454.787,00 | 454.787,00 | 119.470,50 | | 119.470,50 | |
| 4239 | Materiale tjera | 200.000,00 | | 200.000,00 | 361.279,50 | 370.920,00 | 732.199,50 | 366,10 |

## 424 MIRËMABJTJE VIJUESE

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4241 | Riparim dhe mirëmbajtje të veturave | 200.000,00 | | 200.000,00 | 348.504,00 | | 348.504,00 | 174,25 |
| 4244 | Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve | 100.000,00 | | 100.000,00 | 55.705,00 | | 55.705,00 | 55,70 |
| 4242 | Shpenzime për mirëmbajtjen e ndërtesës | 750.000,00 | | 750.000,00 | 1.609.654,50 | | 1.609.654,50 | 214,62 |
| 4244 | Mirëmbajtje e softwerit dhe hardwerit | 250.000,00 | | 250.000,00 | 89.552,50 | | 89.552,50 | 35,82 |

## 425 Shërbime kontraktuese

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4253 | Shërbime avokature | 150.000,00 | | 150.000,00 | 202.361,00 | | 202.361,00 | 134,90 |
| 4257 | Seminare dhe mbledhje | 1.805.000,00 | 6.448.333,00 | 8.253.333,00 | 938.620,00 | 2.007.723,00 | 2.946.343,00 | 35,69 |
| | Organizim dhe zhvillim | 200.000,00 | | 200.000,00 | 179.200,00 | | 179.200,00 | 89,60 |
| | Informim dhe komunikim | 20.000,00 | 100.000,00 | 120.000,00 | 11.580,00 | | 11.580,00 | 9,65 |
| | Diseminim | 150.000,00 | 350.000,00 | 500.000,00 | 9.240,00 | | 9.240,00 | 1,84 |
| | Veprimtari shëndetësore-edukuese | 20.000,00 | 339.829,00 | 359.829,00 | 3.500,00 | 229.471,00 | 232.971,00 | 64,74 |
| | Ndohma e parë | 20.000,00 | | 20.000,00 | 286.338,00 | | 286.338,00 | 1.431,69 |
| | Dhurimi i gjakut | 20.000,00 | 154.400,00 | 174.400,00 | 2.000,00 | 356.640,00 | 358.640,00 | 205,64 |
| | Veprimtari socialo-humanitare | 20.000,00 | 323.000,00 | 343.000,00 | 2.100,00 | 145.688,00 | 147.788,00 | 43,08 |
| | Shërbimi për kërkim | 20.000,00 | 130.000,00 | 150.000,00 | 1.500,00 | | 1.500,00 | 1,00 |
| | Marketing | 20.000,00 | 150.000,00 | 170.000,00 | | | | |
| | Financa | 20.000,00 | | 20.000,00 | | | | |
| | Katastrofa | 20.000,00 | 901.104,00 | 921.104,00 | 9.000,00 | 534.919,00 | 543.919,00 | 59,05 |
| | Njësia për përgjigje gjatë katastrofave (trajnim) | 250.000,00 | | 250.000,00 | 13.300,00 | | | |
| | Njësia ndërkombëtare | | 3.800.000,00 | 3.800.000,00 | 66.462,00 | | 66.462,00 | 1,74 |
| | Mbledhja e Këshillit ekzekutiv | 150.000,00 | | 150.000,00 | 91.860,00 | | 91.860,00 | 61,24 |
| | Kuvendi i KKRM-së | 150.000,00 | | 150.000,00 | 152.840,00 | | 152.840,00 | 101,89 |
| | Mbledhje me sekretarët/kryetarët | 100.000,00 | | 100.000,00 | 54.360,00 | | 54.360,00 | 54,36 |
| | FACE | 400.000,00 | | 400.000,00 | | | | |
| | Rinia | 225.000,00 | 200.000,00 | 425.000,00 | 55.340,00 | 741.005,00 | 796.345,00 | 187,37 |
| 4252 | Provizion bankar | 60.000,00 | | 60.000,00 | 60.788,50 | 28.214,00 | 89.002,50 | 148,33 |
| 4252 | Sigurim i pronës dhe objekteve | 150.000,00 | | 150.000,00 | 1.574,00 | | 1.574,00 | 1,04 |
| 4259 | Shërbime tjera financiare | 753.000,00 | 498.150,00 | 1.251.150,00 | 1.545.477,00 | 1.675.559,00 | 3.221.036,00 | 257,44 |
| 4259 | Marrëveshje tjera kontraktuese | 150.000,00 | | 150.000,00 | 1.173.536,50 | 389.665,50 | 1.563.202,00 | 1.042,13 |

| | PËRSHKRIM | Burime personale | Të hyra nga org. dhe don | Buxheti 2008 | Të realizuara nga burime pers. | Të realizuara nga org. dhe don. | Të realizuara 2008 | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Revizion i jashtëm | 90.000,00 | | 90.000,00 | | | | |
| 4261 | Anëtarësi në organizata ndërkombëtare | 180.000,00 | | 180.000,00 | 196.509,00 | | 196.509,00 | 109,17 |
| **426** | **Të dalura tjera operative** | | | | | | | |
| 4261 | Sigurim të fondeve/vendime gjyqësore | | | | | | | |
| 4261 | Shpenzime për bashkëpunim ndërkombëtar | 300.000,00 | | 300.000,00 | 194.776,00 | | 194.776,00 | 64,92 |
| **463** | **Transfere në organizatat joprofitabile** | | | | | | | |
| 4631 | Transfere në OKKK | | 23.554.949,00 | 23.554.949,00 | | 16.082.116,50 | 16.082.116,50 | 68,27 |
| 4631 | Fondi për zhvillim | | 1.095.000,00 | 1.095.000,00 | | | | |
| | **Të dalura të përgjithshme** | **18.907.000,00** | **36.787.834,00** | **55.694.834,00** | **19.148.031,50** | **24.961.480,00** | **44.096.211,50** | **79,17** |
| | **TË DALURA KAPITALE** | | | | | | | |
| **483** | **Blerje e mobiljeve dhe paisjes për zyre** | | | | | | | |
| 4831 | Blerje e mobiljes për zyre | | 60.000,00 | 60.000,00 | 440.458,00 | | 440.458,00 | 734,09 |
| 4832 | Blerje e paisjes (ETC dhe program për katastrofa) | | 100.000,00 | 100.000,00 | 1.074.992,00 | 2.746.063,50 | 3.821.055,50 | 3.821,05 |
| **483** | **Blerje e automjeteve** | | | | | | | |
| 4833 | Blerje veturë | 400.000,00 | | 400.000,00 | 1.005.020,00 | | 1.005.020,00 | 251,25 |
| **481** | **Mirëmbajtje themelore dhe speciale** | | | | | | | |
| | Investime kapitale në OKKK | 500.000,00 | | 500.000,00 | 240.000,00 | | 240.000,00 | 48,00 |
| | Përkrahje për zhvillim të OKKK | 600.000,00 | | 600.000,00 | 180.000,00 | | 180.000,00 | 30,00 |
| 4812 | Rekonstruim dhe renovim të objekteve ndërtimore | 200.000,00 | | 200.000,00 | 2.491.931,00 | | 2.491.931,00 | 1.245,96 |
| | **Të daluta të përgjithshme kapitale** | **1.700.000,00** | **160.000,00** | **1.860.000,00** | **5.432.401,00** | **2.746.063,50** | **8.178.464,50** | **439,70** |
| | **Të dalura të përgjithshme** | **20.607.000,00** | **36.947.834,00** | **57.554.834,00** | **24.580.432,50** | **27.707.543,50** | **52.274.676,00** | **90,82** |

Shërbimi financiar
Zhaklina Popoviq

Sekretari gjeneral
Sait Saiti

# RAPORTI VJETOR

për vitin 2008 e miratuan anëtarët e Këshillit ekzekutiv të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë

Millço Trajkov

Daut Selimi

Sasho Toçkov

Merita Kolci-Koxhaxhiku

Fatbi Osmani

Kirill Conevski

Dimitrova Dana

Katica Kiprijanova

Kërste Popovski

Dimitar Karakulev

Violeta Ivanovska

Prim. Dr.Kamçev Nikolla

Snezhana Trajkovska

Ilija Ivanovski

Ylber Besimi



DFK INTERNATIONAL
DIMITROV REVIOZION
Shoqatë për revizion

Fahu P. 896, 1000 Shkup
Telefoni: +389 2 3117-888
Tel./Faks: +389 2 3117-999
e-mail:finko@finko.com.mk

**Udhëheqësisë së**
**KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**
**SHKUP**

# RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR

Ne zbatuam revizion në raportet e bashkangjitura financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" (në tekstin e mëtejmë Organizatë), të cilët e kyçin gjendjen e Bilansit më 31 dhjetor 2008, si dhe në Bilansin të hyra dhe të dala, Raportin për të holla në vijim dhe Raportin për ndryshime në fondin e punës për vitin që mbaron atë ditë dhe shqyrtimin e politikave të rëndësishme kontabiliteti dhe shënime tjera sqaruese.

Raportet e bashkangjitura financiare për vitin 2008 përbëhen prej raporteve për punë të rregullt të Organizatës si dhe raportet për projektet: 1) Mbindërtimi i kapaciteteve; 2) Shërbimi për kërkim, diseminim dhe përgatitje; 3) Zhvillim i përbashkët i bashkësisë; 4) Mbindërtim intensiv të kapaciteteve; 5) Fond global për luftë kundër HIV/SIDA; 6) Fond global për përforcim të preventivës, diajgnostikës dhe trajtim të TB; 7) KK Kanadez – Motivim i të rinjëve për dhurim të gjakut; 8) KK Spanjoll – Përkrahja e programit shëndetësor të KKRM-së dhe 9) KK Gjerman – Shërbimi shkollor i Kryqit të Kuq për edukim dhe preventivë. Këto projekte janë të financuara nga donatorë të posaçëm dhe të njëjtit realizohen nëpërmjet nënllogarive të posaçme (qëllimore) të Organizatës. Për ato Organizata nuk përgatit raporte të posaçme financiare.

**Përgjegjësia e menaxhmentit për raportet financiare**

Menaxhmenti i Organizatës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të këtyre raporteve financiare në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprofitabile dhe Standardeve ndërkombëtare kontabiliste për sektorin publik në bazë të gatshme të shpallura në Republikën e Maqedonisë. Kjo përgjegjësi kyç: formën, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit intern që është relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve vjetore të cilat janë të liruara nga tregimi i gabueshëm i materialit, pa dallim se a janë rezultat mashtrimi apo vlerësim kontabiliteti që janë të kuptueshme apo të arsyeshme në rrethana.

**Përgjegjësia e revizorit**

Përgjegjësi e jona është që të shprehim mendimin për këto raporte vjetore në bazë të revizionit tonë. Revizionin e zbatuam në pajtueshmëri me Standardet ndërkombëtare për revizion. Ato standarde kërkojnë që t'i respektojmë kërkesat etike dhe ta planifikojmë dhe zbatojmë revizionin që të fitojmë besim të arsyeshëm për atë se a janë të liruara raportet financiare nga tregimi i gabueshëm i materialit.

Revizioni e kyç zbatimin e proceseve për gjetjen e dëshmive revizore për shumat dhe të nxjerrunit në dritë të raporteve financiare. Proceset e zgjedhura varen nga të gjykuarit e revizorit, duke e kyçur edhe vlerësimin e rreziqeve nga tregimi i gabuar të materialit të raporteve financiare, pa dallim se a janë rezultat i mashtrimit apo gabimit. Kur i bën ato vlerësime të rrezikut, revizori e shqyrton kontrollin intern relevant për përgatitjen dhe prezantimin e raporteve financiare që të formojë procese revizore të cilat janë përkatëse me rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së mendimit për efektivitetin e kontrollit intern. Gjithashtu revizioni kyç edhe notim të përshtatjes së politikave të përdorura kontabiliste dhe arsyes së vlerësimeve kontabiliste të bëra nga ana e menaxhmentit, si dhe notim të prezantimit të përgjithshëm të raporteve financiare.

Ne besojmë se dëshmitë revizore të cilat i kemi gjetur janë të kapshme dhe të përshtatshme që të sigurohen baza për mendimin tonë revizor.

**Mendimi i revizorit**

Sipas mendimit tonë, raportet financiare të bashkangjitura të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" e tregojnë gjendjen financiare të organizatës më 31 dhjetor të vitit 2008 realisht dhe objektiv në të gjitha aspektet e rëndësishme, si dhe rezultatet e punës së saj, rrjedhat e të hollave dhe ndryshimet në fondet për vitet të cilat mbarojnë atë ditë, në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprofitabile dhe Standardeve Ndërkombëtare kontabiliste për sektorin publik të bazës së gatshme të shpallura në Republikën e Maqedonisë.

Shkup, 27 shkurt 2009

Drejtor
Zvonko Koçovski, Revizor i autorizuar

ДРУШТВО ЗА РЕВИЗИЈА ДИМИТРОВ РЕВИЗИЈА ДОО Скопје

# HETIM I MENDIMIT PUBLIK PËR BESIM NË SHOQËRINË QYTETARE

Gjatë vitit 2008 nga ana e Qendrës Maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar është zbatuar hetim i mendimit publik për besimin në shoqërinë qytetare. Një pjesë e rezultateve nga hetimi i zbatuar tregojnë në mendim pozitiv të një pjese më të madhe të të pyeturëve në bazë të punës dhe aktivitetet e Kryqi të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

## Njohja e organizatave qytetare






# QËNDRIME (pozitive/negative) për organizatat qytetarë

Nga fillimi i çdo listeje të 24 organizatave është kërkuar që të përgjigjen se a kanë qëndrim pozitiv apo negativ për organizatë përkatëse.

Qëndrimet pozitive për organizatat qytetare janë më të shpeshta kundrejt atyre negative. Paraqitja e qëndrimeve negative për organizata konkrete kryesisht është te pakicat jotërëndësishme (deri 10%). Për 8 (1/3) nga 24 organizatat e treguara qëndrimet negative janë mbi 10% (nga 1,6 deri 20,4%) që paraqet pakicë të vogël nga të pyeturit.

**Raporti i qëndrimeve pozitive kundrejt atyre negative për organizata të caktuara qytetare**



# FALENDERIM

## deri te vullnetarët, anëtarët e organizatës, partnerët dhe donatorët

**Jemi të vetëdijshëm se arritjet dhe optimizmi ynë detyrohen në angazhimet dhe kontributin e vullnetarëve tanë, anëtarëve të organizatës, udhëheqësisë, drejtorisë dhe të punësuarëve, dhe me sinqeritet iu falenderohemi për përkushtueshmërinë dhe angazhimin e tyre për arritjet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në vitin 2008. Njëkohësisht dëshirojmë që të shprehim falenderim për përkrahjen e vazhdueshme të partnerëve tanë nga vendi dhe jashtë vendit – institucionet qeveritare, organizatave joqeveritare, mediumeve, ndërmarjeve, qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Federatës Ndërkombëtare dhe shoqatave nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe.**

Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe

Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

Kryqi i Kuq i Kanadës

Kryqi i Kuq i Spanjës

Kryqi i Kuq i Austrisë - ShTAER

Kryqi i Kuq i Gjermanisë

Kryqi i Kuq i Gjermanisë në Baden Virtemberg

Komesariati i lartë për ikacakë

UNDP

Organizata Ndërkombëtare për migrime

Fondi global për luftë kundër SIDA, tuberkulozit dhe malaries

NVO AESEK

Ministria për mbrojtje

Qendra për menaxhim me kriza

Ministria për punë të brendëshme

Drejtoria doganore e RM-së

Ministria për punë dhe politikë sociale

Ministria për shëndetësi

Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha dhe tuberkulozit

Fondacioni T - Mobile Maqedoni

COSMOFON

VIP

COLGATE Palmolive Adria

Panairi i Shkupit

# Marëveshje dhe Memorandume për bashkëpunim

*ЦKryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë me qëllim që ti rregullojë raportet e ndërmarura për zhvillim të mëtejshëm, bashkëpunim, marrëdhënie partnerore dhe përkrahje me institucione qeveritare dhe organizata ndërkombëtare gjatë vitit 2008 nënshkroi marrëveshje dhe memorandume për bashkëpunim me:*

*Ministrinë për punë të brendëshme*

*Ministrinë për punë të brendëshme dhe Entin Republikan për Transfuziologji*

*Ministrinë për punë dhe politikë sociale*

*Lidhja e shoqatave të penzionerëve të Maqedonisë*

*Fakultetin e Mjekësisë në Univerzitetin "Shën Qirili dhe Metodi" – Shkup*

*Qendrën për menaxhim me kriza*

*Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim*

*UNDP*

*Gjysëmhënën e Kuqe të Turqisë*

*Kryqin e Kuq të Gjermanisë*

*Kryqin e Kuq të Spanjës*





# 2008 2008 2008

ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ RAPORTI I PUNËS ANNUAL REPORT

www.redcross.org.mk